



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

RAPORT

MBI FUNKSIONIMIN E KUVENDEVE TË KOMUNAVE TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS

JANAR-MARS 2012

Prill, Prishtinë 2012

Hyrje

Në përputhje me detyrimet ligjore dhe mandatin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Departamenti për Vetëqeverisje Lokale, përmes Divizionit të Monitorimit, edhe gjatë periudhës janar–mars të vitit 2012 ka vazhduar mbikqyrjen e punës së komunave në korelacion me respektimin e legjislacionit në fuqi.

Komunat janë të obliguara që veprimtarinë e tyre të ushtrojnë në përputhje me Kushtetutën, parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjet e tjera të cilat prekin nivelin lokal.

Prezantimi i aktiviteteve të kuvendeve të komunave ka rëndësi të shumfishtë, ngase me ligj kuvendi i komunës njihet organi më i lartë në strukturën organizative të komunës. Së këndejmi, pasqyrimi i punës së kuvendeve të komunave përfshinë në mënyrë indirekte edhe shpalosje e punës së ekzekutivit, duke ditur se ky i fundit raporton në baza të rregullta ose kur kërkohet në Kuvendin e Komunës. Andaj, ky raport ka për qëllim informimin e qytetarëve, institucioneve relevante qeveritare dhe joqeveritare, por edhe vetë komunave, lidhur me nivelin e respektimit të ligjshmërisë nga komuant, te cilat duke marrë për bazë gjetjet e paraqitura në këtë raport, duhet të ndërmarrin për të korrigjuar veprimet kundërligjore.

MAPL, gjegjësisht Divizioni i Monitorimit në kuadër të Departamentit për Vetëqeverisje Lokale, vazhdimisht monitoron seancat e kuvendeve komunale. Shkeljet e evidentuara i adreson në Departamentin Ligjor të MAPL-së për procedim të mëtejme sipas rregullave të legjislacionit në fuqi.

Qëllimi

Përmes këtij Raporti mundohemi t'u krijojmë informim të duhur qytetarëve lidhur me aktivitetet e të zgjedhurve të tyre lokal.

Raporti shërben edhe si një mjet tjetër që do të rrisë transparencën në lidhje me aktivitetin e pushtetit lokal për periudhën e raportimit.

Në raport janë përfshirë të dhëna të përgjithshme rreth funksionimit të Kuvendeve të Komunave. Po ashtu, përfshihen edhe gjetjet më të rëndësishme të evidentuara gjatë kësaj periudhe. Dokumenti është hartuar në pjesë të ndara, duke përfshirë nga katër, pesë ose gjashtë komuna në grupe, varësisht nga numri i komunave që monitorojnë zyrtarët përgjegjës.

Në kuadër të raportit, përfshihen të dhëna për 34 komuna të Republikës së Kosovës, ndërkohë për Komunën e Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potokut nuk kemi të dhëna.

PËRMBAJTJA

HYRJE

QËLLIMI

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

MBLEDHJET E MBAJTURA

TRANSPARENCA

NUMRI I AKTEVE TË MIRATUARA

AKTETET MË TË RËNDËSISHME

KËSHILLAT KOMUNALE PËR SIGURI NË BASHKËSI

PËRMBLEDHJE NGA MBLEDHJET E MBAJTURA

TË GJETURAT

SHKELJET LIGJORE

KONFLIKTET E INTERESIT

KONKLUZIONET

REKOMANDIMET

KOMUNAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Deçan
Dragash
Fushë Kosovë
Ferizaj
Gjakovë
Glllogoc
Graçanicë
Gjilan
Hani i Elezit
Istog
Junik
Kamenicë
Kaçanik
Klinë
Kllokoti
Lipjan
Mitrovicë
Malishevë
Mamushë
Novobërdë
Obiliq
Pejë
Prishtinë
Podujevë
Prizren
Partesh
Rahovec
Ranillug
Skenderaj
Shtime
Shtërpçë
Suharekë
Viti
Vushtrri
Zubin Potokut
Zvecanit
Leposavicit

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Edhe gjatë periudhës janar – mars të vitit 2012, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka përcjellur në koherencë punën e Kuvendeve të Komunave të Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim, Divizioni i Monitorimit përmes punës së vazhdueshme ofron të dhëna nga aktivitetet e Komunave në kontekst të zbatimit të ligjeve në fuqi.

MAPL, përdor sisteme të avancuara të teknologjisë informative dhe të komunikimit. Nga muaji janar i vitit 2012, monitorimi i mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave bëhet përmes sistemit të teleprezencës. Kjo mënyrë e monitorimit dhe e komunikimit ka mundësuar një lidhje direkte me Kuvendin. Në shumicën e Komunave, lidhja e realizuar ka qenë e kënaqshme, qoftë për nga transmetimi i zërit, po ashtu edhe për nga pamjet vizuale të shfaqura si video.

Më tej, raporti nënvizon dhe konstaton se veprimet e Komunave janë relativisht mirë në kuptimin e përputhshmërisë dhe zbatueshmërisë me legjislacionin në fuqi. Raporti fillon me identifikimin e veprimeve fillestare të Komunave, duke filluar nga dërgimi i ftesave dhe materialeve për mbledhje të kuvendeve, njoftimi i tyre me kohë, rendi i ditës, kuorumi, respektimi i Rregullores së Punës së Kuvendit, dërgimi i akteve komunale në adresë të organit mbikëqyrës, transparenca komunale, përputhshmëria e akteve komunale me legjislacionin në fuqi, shkeljet e ndryshme ligjore.

Po ashtu, raporti tregon se të gjitha komunat kanë mbajtur numër të mjaftueshëm të mbledhjeve për periudhën tremujore. Në përgjithësi, Komunat janë treguar aktive në nxjerrjen e akteve komunale në Kuvend dhe se ndjeshëm kanë ulur shkallën e shkeljeve ligjore gjatë miratimit të tyre në këtë periudhë raportuese.

MAPL është autoritet mbikëqyrës i komunave, këto të fundit janë të obliguara që konform nenit 80 të LVL-së të përcjellin aktet e miratuara nga kuvendi për shqyrtim të ligjshmërisë. Mirëpo, jo të gjitha Komunat e kanë respektuar si rregull këtë kriter ligjor. Gjithashtu, edhe sa i përket publikimit të akteve komunale në ueb faqet zyrtare, jo të gjitha komunat i publikojnë këto akte në ueb faqet zyrtare. Në lidhje me këtë çështje, në Komuna ende nuk është krijuar një sistem unik i publikimit të akteve komunale në ueb faqet zyrtare, po ashtu, disa prej tyre nuk e praktikojnë fare këtë mundësi.

Duke marrë parasysh se në këtë periudhë komunat janë përballur me gjendje emergjente për shkak të reshjeve të mëdha të borës, disa prej komunave kanë shpallur gjendje të jashtëzakonshme, gjë që bje ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ku në nenin 84 pika 22, përcaktohet që Presidenti i Republikës së Kosovës të vendos për shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, në konsultim me Kryeministrin.

KOMUNAT: GJAKOVË, RAHOVEC, DEÇAN, JUNIK

Mbledhjet e mbajtura

Komunat Gjakovë, Rahovec, Deçan dhe Junik gjatë periudhës janar-mars të vitit 2012 kanë mbajtur një numër të mbledhjeve të kuvendit të komunës. Në kuvendet e këtyre komunave gjatë kësaj periudhe janë mbajtur gjithsej dhjetë mbledhje të rregullta dhe tri të jashtëzakonshme. Më detajisht në vijim kemi paraqitur figurën e mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave:




Fig. 1. Numri i mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave: Gjakovë, Deçan, Junik dhe Rahovec

Nga figura 1 vërejmë se numrin më të madh të mbledhjeve e ka mbajtur Kuvendi i Komunës së Deçanit. Krahas kësaj komune, Gjakova dhe Juniku qëndrojnë në të njëjtin ritëm të mbledhjeve, ndërsa Rahoveci ka mbajtur dy mbledhje.

Edhe komitetet për komunitete kanë qenë funksionale në këtë periudhë. Kësisoj, këto komitete kanë mbajtur këtë numër të takimeve, të elaboruar në vijim:




Fig. 2. Numri i mbledhjeve të Komiteteve të obligueshme: Gjakovë, Deçan, Junik dhe Rahovec

Nga pasqyrimi i mësipërm shohim se edhe në mbajtjen e mbledhjeve të Komiteteve Komuna e Deçanit ka treguar performancë më të mirë. Megjithatë, në të gjitha komunat funksionimi i këtyre komiteteve ka qenë i rregullt. Madje, nga figura shohim se Komiteti për Komunitete ka qenë ekuivalent me Komitetin për Politikë dhe Financa, për të cilën tregojnë të dhënat e takimeve.

Një lloj tjetër të komiteteve për të cilat komunat janë të obliguara me ligj t'i themelojnë janë komitete konsultative. Deri tani, në asnjërën prej komunave në fjalë nuk janë themeluar të tilla komitete.

Krahas kësaj, sa u përket mbledhjeve të kuvendit, të gjitha mbledhjet e kuvendeve kanë qenë të hapura për publikun. Informimi i qytetarëve në vazhdimësi është bërë përmes ueb-faqes zyrtare të komunës, shpalljeve publike të vendosura në objektet e komunës, por edhe përmes televizioneve lokale. Ndërkohë, ajo që është vërejtur tregon se qytetarët nuk duken edhe aq të inkurajuar për të qenë pjesëmarrës në takimet e kuvendit. Madje, edhe tubimet publike të organizuara lidhur me çështjet e interesit të përgjithshëm, siç mund të jenë miratimi i rregulloreve apo planeve të ndryshme komunale, nuk i ka nxitur qytetarët për të qenë pjesëmarrës. Megjithatë, komunat janë kujdesur të respektojnë rregullat për njoftimin e qytetarëve me rastin e diskutimeve publike. Për më tepër, ueb-faqet zyrtare të komunave në vazhdimësi kanë qenë azhurnuara me informacione dhe aktivitetet e komunave. Madje, duke marrë parasysh sistemin e teleprezencës të instaluar në komuna, është krijuar mundësia e vendosjes së aplikacioneve në ueb-faqet zyrtare, ku qytetarët të kenë mundësinë për vëzhgimin e mbledhjeve të kuvendeve. Një mundësi e tillë është praktikuar më tepër nga Komuna e Junikut.

Sa i përket informimit dhe komunikimit me organin mbikëqyrës, përkatësisht Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal komunat qëndrojnë relativisht mirë në këtë drejtim. Në shumicën e rasteve ftesa për mbledhjet e kuvendit ka arritur me kohë, mirëpo jo të gjitha komunat dërgojnë materialet e mbledhjeve të bashkangjitur me ftesë. Për më saktë, është Komuna e Deçanit ajo e cila nuk i dërgon materialet e mbledhjeve me kohë.

Mirëpo, krahas një aspekt tjetër i rëndësishëm për t'u elaboruar dhe që lidhet direkt me mandatin ligjor të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal është shqyrtimi administrativ i akteve komunale. Ky lloj i shqyrtimit nënkupton shqyrtimin e rregullt të ligjshmërisë së akteve komunale, për të cilat akte ligji nuk ka përcaktuar në kompetencë të ndonjë ministrie tjetër të realizoj atë. Në këtë kontekst, me qëllim të koordinimit ndërministror për të realizuar shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve komunale, janë themeluar komisionet përkatëse, varësisht nga fushat që prekin aktet e miratuara. Meqenëse MAPL-është autoritet mbikëqyrës i komunave, këto të fundit janë të obliguara që konform nenit 80 të LVL-së të përcjellin aktet e miratuara nga kuvendi për shqyrtim të ligjshmërisë. Mirëpo, fatëkeqësisht evidente është fakti që komuna e Rahovecit, Junikut dhe e Deçanit nuk respektojnë si rregull këtë kriter ligjor.

Duke marrë parasysh se në këtë periudhë komunat janë përballur me gjendje emergjente për shkak të reshjeve të mëdha të borës, vërehet numri i madh i mbajtjes së mbledhjeve të jashtëzakonshme të kuvendit. Madje, disa prej komunave (Deçani,

Juniku) shpallën edhe gjendje të jashtëzakonshme, gjë që binte ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ku në nenin 84 pika 22, përcaktohet që Presidenti i Republikës së Kosovës të vendos për shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, në konsultim me Kryeministrin.

Aspekt tjetër i rëndësishëm për t'i përmbledhur në këtë pjesë të raportit është edhe fusha e sigurisë së përgjithshme të qytetarëve. Është i njohur fakti se në komuna janë funksionale trupat këshillëdhënëse për siguri, të njohura si Këshillat komunale për siguri në bashkësi (KKSB-të). Sipas të dhënave, këto këshilla në këtë periudhë kanë mbajtur këtë numër të takimeve:




Fig. 3. Numri i takimeve të KKSB-ve në komunat: Gjakovë, Deçan, Junik dhe Rahovec.

Nga figura e mësipërme vërejmë se Komuna e Gjakovës ka realizuar vetëm një takim, ndërkohë tri komunat e tjera kanë mbajtur nga dy mbledhje. Në përgjithësi, mund të themi se komunat nuk i kushtojnë rëndësinë e duhur Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Përmbledhje nga mbledhjet e kuvendeve

Gjakova

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në periudhën janar-mars 2012 është mbledhur gjithsej 3 herë. Rrjedhojë e punës së kuvendit ishte miratimi i 8 vendimeve, kurse një Rregullore është shfuqizuar dhe një është miratuar.

Në mbledhjen e muajit janar, Kuvendi i Komunës së Gjakovës ka miratuar 3 vendime dhe ka shqyrtuar raportin e kryetarit të komunës për periudhën janar-shtator 2011. Në këtë mbledhje, me një vendim u miratua ndryshimi i komisionit për identifikimin dhe dhënien në shfrytëzim të banesave në ndërtesën për banim social - vendim i vitit 2010. Po ashtu, me propozimin e kryetarit të komunës, Kuvendi me vendim ndryshoi nenin 55 dhe 56 të Statutit të Komunës. Me këto ndryshime, nga neni 55 hiqet paragrafi dhe i shtohet neni 55, gjegjësisht “Mbrojtja e tokës në pronësi Komunale nga uzurpimet dhe udhëheqja e procedurave të ndërlidhura me këtë çështje”, e që nënkupton se kompetenca për mbrojtjen e pronës komunale kalon nga drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Komasaçion në drejtorinë e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Kuvendi po ashtu shfuqizoi Rregulloren për EKO-taksa, që ishte kërkesë e komisionit të përbashkët MAPL-MMPH për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të Komunave në ushtrimin e kompetencës vetanake lidhur me “mbrojtjen e mjedisit lokal”.

Në mbledhjen e shkurtit Kuvendi i Komunës ka miratuar 3 vendime. Në mesin e vendimeve është formuar komisioni prej 7 anëtarëve për organizimin e manifestimeve për nder të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë. Gjithashtu, është miratuar kërkesa e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për plotësimin e vendimeve mbi caktimin e tokës ndërtimore urbane në disa zona kadastrale, përfshirë edhe zonën industriale të qytetit.

Në vazhden e aktiviteteve të Kuvendit, në muajin mars është janë miratuar po ashtu një numër vendimesh. Ndër më të rëndësishmet, mund të përmendet miratimi i Rregullores për Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjakovës, me Vendim është aprovuar Raporti financiar i Buxhetit të Komunës së Gjakovës, për periudhën Janar-Dhjetor 2011 (edhe pse LVL nuk obligon miratimin e raporteve). Po ashtu, Kuvendi me Vendim ka miratuar kërkesën e z. Rexhep Jemin Kastrati nga Gjakova për dhënien në shfrytëzim të një pjese prej 0,02.22 (222 m²) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 0.16.37.ha të paluajtshmërisë, në ngastrën 5526/34 z.k Gjakovë - J për destinim shndërrimi në “oazë të gjelbëruar”. Ky vendim bie ndesh me Ligjin nr.03/L-226 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Krahas Kuvendit të Komunës, gjatë kësaj periudhë kanë funksionuar edhe Komitetet e obligueshme. Së këndejmi, Komiteti për Politikë dhe Financa është mbledhur tri herë, ndërkohë Komiteti për Komunitete ka mbajtur

Me qëllim të sjelljes së vendimmarrjes sa më afër qytetarëve, komuna ka organizuar një numër takimesh publike. Në diskutim publik ka kaluar Rregullorja për Mbrojtjen e Mjedisit, Plani Rregullues Urban i kompleksit urbanistik përgjatë rrugës regjionale Gjakovë-Prizren, rishikimi i segmentit rrugor dhe rregullimi i lokacionit nga Rruga “Anton Çeta” deri në rrugën “Dëshmorët e Lirisë” etj.

Sa i përket Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, gjatë kësaj periudhën ky këshill ka mbajtur 2 takime.

Junik

Gjatë periudhës janar-mars 2012, Komuna e Junikut ka thirrur gjithsej 3 mbledhje. Në muajin janar dhe shkurt Kuvendi ka mbajtur mbledhje të rregullta, ndërsa në muajin mars ftesa e mbledhjes është dërguar për në muajin prill.

Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi i Komunës së Junikut ka shqyrtuar agjendë të ngjeshur të propozim-vendimeve dhe propozim-Rregulloreve komunale. Meqenëse ishte fillimi i vitit, në mbledhjen e muajit janar Kuvendi miratoi Planin e punës së Kuvendit për vitin 2011 si dhe vendimin për orarin e takimeve. Po ashtu, Kuvendi veproi mbi bazën e propozimit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa duke miratuar bartjen e mjeteve të pashpenzuara të vitit 2011 në vitin 2012 sipas kategorive përkatëse. Së këndejmi, u miratua edhe një Rregullore e cila përcaktonte kufijtë dhe kriteret e përdorimit të pijeve alkoolike në lokalet publike në Komunën e Junikut. Koto ishin disa nga vendimet e muajit janar, ndërkohë edhe në muajin shkurt Kuvendi tregoi efikasitet në miratimin e akteve komunale. Kësisoj, në mbledhjen e shkurtit, Kuvendi shqyrtoi dhe miratoi Draft-Rregulloren për përdorimin e automjeteve zyrtare, Rregulloren për kompetencat, përgjegjësitë dhe punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës, si dhe Planin Rregullues Urban “Njësia Gacafer-Pepsh”. Pjesë e punës shqyrtuese të Kuvendit ishin edhe disa raporte, siç ishte Raporti për projektin e rregullimit të shtratit të lumit “Erenik”, gjegjësisht faza e dytë e projektit, si dhe vendimi mbi plotësimin e numrit të anëtarëve të Këshillit të Ekspertëve të Planifikimit të Komunës.

Siç është përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, përgjegjësi e kryetarit të komunës është raportimi para kuvendit së paku një herë në gjashtë muaj ose kurdo që kërkohet. Në bazë të monitorimit është vërejtur se në Komunën e Junikut, megjithëse kryetari ka raportuar në muajin prill, mund të themi se kemi pasur raportim të vonuar. Ligji ka përcaktuar periudhën prej një herë në gjashtë muaj si kriter ligjor i fundit për raportim, kështu që ky kriter duhet të respektohet dhe në të ardhmen të merret parasysh nga kryetari i komunës

Me qëllim të ofrimit të transparencës për qytetarë, në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut janë transmetuar direkt mbledhjet e Kuvendit të Komunës. Paraprakisht komuna në adresën zyrtare është kujdesur në informimin e qytetarëve lidhur me kohën e mbajtjes së mbledhjeve dhe njoftimin për transmetimin direkt të punimeve të kuvendit. Kësisoj, përveç lidhjes direkte me MAPL për të monitoruar seancat, komuna ka krijuar edhe aplikacionin për qytetarë ku ata mund të klikojnë për të vëzhguar punimet e kuvendit. Kjo është një praktikë e mirë e Komunës së Junikut, e cila ka treguar efikasitet në menaxhimin e pajisjeve për teleprezencë për qëllime informuese. Përveç kësaj, ueb-faqja zyrtare është azhurnuar në vazhdimësi për aktivitetet e komunave. Mirëpo, ende mbetet për t’u përmirësuar sistemi i publikimit të akteve të miratuara në Kuvendin e Komunës.

Komiteti për Politikë dhe financa – Ky komitet gjatë periudhës janar-mars 2012 ka mbajtur gjithsej 3 takime. Si rregull, komiteti është thirrur para mbajtjes së mbledhjeve

të Kuvendit, në të cilin janë trajtuar çështjet kryesore të planifikuara për shqyrtim në mbledhjet e Kuvendit të Komunës.

Ndërsa, edhe pse Komuna e Junikut nuk ka komunitete pakicë, përfaqësimi në Komitetin për Komunitete rrjedh nga radhët e komunitetit shumicë. Andaj, përbërja e këtij komiteti reflekton përfaqësuesit e lagjeve të ndryshme të Komunës së Junikut. Formimi dhe funksionalizimi i këtij komiteti është përmbushje e një pjese të kuadrit ligjor për vetëqeverisje lokale nga Komuna e Junikut. Në këtë kontest, Komiteti ka qenë funksional dhe është mbledhur tri herë. Ndër temat kryesore të diskutuara në mbledhjet e komitetit kanë qenë projektet kapitale për vitin 2012, çështje të sigurisë së qytetarëve, shërbimet publike etj.

Edhe në këtë komunë, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka vazhduar me mbajtjen e takimeve, me ç'rast është mbledhur dy herë.

Deçan

Gjatë periudhës janar-mars, Komuna e Deçanit ka qenë mjaft aktive në zhvillimin e takimeve të Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve. Në këtë periudhë Kuvendi ka mbajtur 4 mbledhje të rregullta dhe tri të jashtëzakonshme. Njëra nga mbledhjet e rregullta me plan të punës ka qenë e paraparë për vitin 2011 mirëpo për shkak të shtyrjes së saj është mbajtur në janar të këtij viti. Sa u përket mbledhjeve të jashtëzakonshme Kuvendi ka thirrur gjithsej tri mbledhje. Gjendja e rëndë e pyjeve ka qenë temë e vazhdueshme e diskutimeve në kuvend, kështu që një mbledhje e jashtëzakonshme është thirrur pikërisht për këtë temë. Në këtë mbledhje, Kuvendi, me qëllim të mbrojtjes së pyjeve miratoi Moratorium të përkohshëm, me të cilin do të ndërpriteshin të gjitha kontratat me operatorët ekonomik të cilët posedonin leje për prerje të pyjeve, deri në vlerësimin e gjendjes së krijuar. Ndërsa, mbledhja e dytë e jashtëzakonshme është mbajtur për shkak të situatës së krijuar nga reshjet e mëdha të borës për të cilën komuna kishte shpallur gjendje të jashtëzakonshme. Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për ndarjen e 80.000 € për tejkalimin e kësaj situate. Krahas kësaj, në muajin mars Kuvendi thirri mbledhjen tjetër të jashtëzakonshme, në të cilën unanimisht përkrahu themelimin e grupit të grave këshilltare të këtij kuvendi, me qëllim të sigurimit të respektimit të Ligjit për barazi gjinore.

Sa u përket mbledhjeve të rregullta, në janar kuvendi ka mbajtur dy mbledhje dhe ka miratuar një numër vendimesh. Në mbledhjen e mbajtur në janar, në mesin e disa vendimeve është miratuar Rregullorja për taksa dhe ngarkesa për shërbimet komunale, miratimi i së cilës kërkohet edhe me Ligjin për financat e pushtetit lokal. Ndërsa, në mbledhjen e parë të rregullt sipas planit të miratuar për vitin 2012 e mbajtur po ashtu në muajin janar, Kuvendi i Komunës ka shqyrtuar dhe miratuar vendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Fabrikës së Mjaltit¹, ndërkohë është miratuar edhe Plani i punës së Kuvendit për vitin 2012.

¹ Projekt i financuar nga Komisioni Evropian

Ndërsa në mbledhjen e dytë të rregullt, Kuvendi ka aprovuar raportin teknik financiar të projekteve kapitale për vitin 2011. Në këtë mbledhje është miratuar gjithashtu vendimi për preorientimin e të hyrave vetanake të bartura nga viti i kaluar.

Duke ditur mangësitë e Statutit të Komunës së Deçanit dhe problemet e vazhdueshme që ka shkaktuar, dhe duke ditur se numri i drejtorive të komunës nuk përputhet me numrin e kërkuar me Statut, e po ashtu edhe një nen i cili parasheh miratimin e propozim-buxhetit me 2/3 e votave (i cili është në kundërshtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale), komuna e ka parë të nevojshme themelimin e një komisioni me qëllim të ndryshimit të këtij Statuti. Si rrjedhojë, në këtë mbledhje Kuvendi ka aprovuar vendimin për themelimin e Komisionit të përbashkët me detyrë të inicimit të procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës.

Në muajin mars kuvendi ka mbajtur mbledhjen e tretë, rrjedhojë e së cilës ishte shtyrja e shqyrtimit të raportit të shpenzimeve të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për shkak të mosprezencës së drejtorit të kësaj drejtorie. Kurse, ndër çështjet kryesore të kësaj mbledhje ishte shqyrtimi i raportit mbi shpenzimet e mjeteve të ndara muaj më parë nga Kuvendi për tejkalimin e gjendjes së krijuar nga reshjet e borës, ku edhe pati një varg kritikash nga opozita për mënyrën e menaxhimit të këtyre mjeteve.

Sa i përket punës së Komiteteve obligative, ato kanë qenë funksionale edhe në këtë periudhë. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 4 mbledhje, ndërkohë Komiteti për Komunitete ka mbajtur tri mbledhje. Edhe Komuna e Deçanit ka numër të vogël të komuniteteve pakicë, megjithatë përfaqësimi në Komitetin për Komunitete përfshinë pjesëtarë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, një pjesëtar të komunitetit serb, përfaqësues të fshatrave dhe pjesëtar nga komuniteti shqiptar. Ky komitet ka gjithsej 7 anëtarë.

Një hap përpara sjelljes së qytetarëve më afër vendimmarrjes LVL ka paraparë themelimin e komiteteve konsultative. Mirëpo, në Komunën e Deçanit ende nuk është themeluar ndonjë komitet i tillë. Themelimi i këtyre komiteteve përveç aspektit të sjelljes së qytetarëve më afër hartimit të politikave, dhënies së propozimeve dhe hulumtimeve të ndryshme, ka edhe aspektin pozitiv profesional që mund të ofrojnë këto komitete, ngase përbërja e tyre përfaqëson persona (ekspertë) të fushave përkatëse. Andaj, komuna duhet t'i kushtoj vëmendje më të theksuar themelimit të këtyre komiteteve.

Krahas kësaj, trup këshillëdhënës që sjell qytetarët më afër komunikimit me komunën është Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi. Siç është i njohur fakti, fusha e veprimit të këtij këshilli i takon çështjes së sigurisë së qytetarëve. Në këtë kontekst, KKSB në Komunën e Deçanit mbetet funksionale dhe gjatë kësaj periudhën ka mbajtur 2 takime.

Rahovec

Gjatë periudhës janar-mars, rrjedha e punës së Kuvendit të Komunës së Rahovecit të vitit 2012 nuk ka qenë e rregullt. Dy mbledhjet e thirrura nga komuna kanë dështuar si rezultat i mospjesëmarrjes së një numri të anëtarëve të kuvendit. Lidhur me këtë, në muajin janar të vitit 2012, me kërkesën e 11 kuvendarëve të Komunës së Rahovecit është thirrur mbledhja e jashtëzakonshme me të vetmen pikë të rendit të ditës – “Shqyrtimi i votëbesimit të kryesuesit të Kuvendit të Komunës”. Mbledhja e thirrur ka dështuar për shkak të mungesës së kuorumit. Kuvendarët që nënshkruan kërkesën për mocionin e votëbesimit të kryesuesit të kuvendit, ishin ata të cilët nuk morën pjesë në këtë mbledhje, me arsyetimin e dhënë nga përfaqësuesi i tyre për shkeljen e dispozitave të LVL-së të cilat përcaktojnë kohën e njoftimit për mbledhje të jashtëzakonshme. Për këtë çështje, është kërkuar sqarim ligjor nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Në kërkesën për interpretim ligjor të parashtruar MAPL-së, pala kërkuese ka pretenduar se është bërë shkelje e nenit 44.4 të LVL-së, përkatësisht nga ana e kryesuesit të kuvendit me rastin e dërgimit të ftesës së parakohshme për mbledhje të jashtëzakonshme. Si rrjedhojë, MAPL ka vlerësuar kërkesën në favor të parashtruesve të kërkesës, duke kërkuar nga kryetari i komunës dhe kryesuesi i Kuvendit të ndërmarrin veprime konkrete që Kuvendi i Komunës së Rahovecit të funksionoj në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Një përgjigje e tillë në shkresë, nënkupton faktin që kryesuesi i kuvendit duhej të thërriste rishtazi një mbledhje të jashtëzakonshme me qëllim të respektimit të dispozitave të nenit 44 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Në ndërkohë, ishte planifikuar mbledhja e rregullt. Si rrjedhojë, në fillim të muajit shkurt, mbledhja e thirrur përfundoi pa nisur fare. Edhe kjo mbledhje ka dështuar për shkak mungesës së kuorumit, që lidhet direkt me pakënaqësinë ndaj kryesuesit të kuvendit të komunës nga një pjesë e kuvendarëve të Rahovecit.

Megjithatë, në muajin mars është thirrur përsëri mbledhje e jashtëzakonshme, me propozimin për shqyrtimin e votëbesimit të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës. Mirëpo, ndryshe nga ishte paraparë të votohej për shkarkimin e tij, kryesuesi i kuvendit të komunës ofroi dorëheqjen pa kaluar në votim. Ky veprim krijoi hapësirë për zgjedhjen e kryesuesit të ri të Kuvendit, ku me votim të fshehtë z. Xhemali Haxhimustafa zgjidhet kryesues i Kuvendit të Komunës së Rahovecit.

Duke marrë parasysh se për një periudhë dy-mujore, për shkak të përplasjeve të subjekteve politike dhe problemeve të vazhdueshme pothuajse ishte bllokuar funksionimi i organit më të lartë në komunë (Kuvendit), menjëherë pas zgjedhjes së kryesuesit është vërejtur normalizim i funksionimit të këtij organi. Përkitazi me këtë, në muajin mars u thirrën dy mbledhje të rregullta. Në mbledhjen e parë të rregullt, në muajin mars Kuvendi miratoi Planin e punës së Kuvendit për vitin 2012. Mirëpo në ndërkohë kuvendi me Aktvendim miratoi propozimin për kthimin e tokave të NBI-“Rahoveci” në emër të Komunës së Rahovecit. Me këtë Aktvendim komuna ka përcaktuar të “ndërpritet shfrytëzimi i metutjeshëm i tokës bujqësore në pronësinë shtetërore NBI “Rahoveci” dhe rikthehet në emër të KK Rahovec”. Megjithëse ende nuk është shqyrtuar ligjshmëria e këtij vendimi, tendenca për të kthyer në pronësi komunale pronat e ish-ndërmarrjeve shoqërore, përbënë shkelje të dispozitave të Ligjit për

Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 03/L-067, me të cilat AKP është e autorizuar të administroj me ndërmarrjet në pronësi shoqërore dhe asetet e tyre.

Përveç kësaj, në këtë mbledhje Kuvendi gjithashtu miratoi Vendimin për shpalljen e Zonës së veçantë të interesit publik. Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Rahovecit, pronat në shfrytëzim të ndërmarrjes “Ekonomia e Pyjeve”, OP “Sharri” dhe disa ngastra në pronësi shtetërore të Kosovës, i shpallë Zonë e veçantë të interesit publik komunal. Për më tepër, në nenin 3 të këtij Vendimi theksohet se “Komuna e Rahovecit, si Njësi kompetente e autoriteti publik, fiton të drejtën e pronësisë në këtë paluajtshmëri me regjistrimin e saj në regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri” - paragraf i cili bie në kundërshtim me vetë qëllimin e Vendimit. Sipas kësaj, mund të themi se me një vendim është vendosur për dy çështje të ndryshme: njëra për shpalljen e zonës së veçantë të interesit të përgjithshëm dhe tjetra për marrjen e së drejtës së pronësisë dhe kthimin e tyre në emër të komunës. Për shkak të mosdërgimit të akteve nga Komuna e Rahovecit për të mundësuar shqyrtimin administrativ, ligjshmëria e këtij vendimi ende nuk është realizuar. Deri në vlerësimin e ligjshmërisë së këtij vendimi nga organi mbikëqyrës, ai mbetet i pazbatueshëm dhe nuk mund të krijoj efekte juridike.

Edhe mbledhja e dytë e rregullt, po ashtu e mbajtur në muajin mars, me rastin e nxjerrjes së akteve nënligjore nuk ka kaluar pa shkelje ligjore². Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës, me Aktvendim ka miratuar kërkesën e Kompanisë KNGS sh.p.k.-Prishtinë për dhënien në shfrytëzim me koncesion të pronës së paluajtshme komunale, për ndërtimin dhe operimin e objektit për tregtimin e lëndëve djegëse – gazit të naftës së lëngëzuar, në kohëzgjatje prej 10 (dhjet) viteve dhe me të drejtë vazhdimi. Së pari, ky vendim bie ndesh me Ligjin nr.03/L-226 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, i cili në nenin 5.3 përcakton se Kuvendi i Komunës ka të drejtë të japë në shfrytëzim pronën e paluajtshme në afat më të gjatë së dhjetë (10) vjet por jo më shumë së dyzet (40) vjet pas plotësimit të kriterëve të përcaktuara më Ligjin për prokurimit dhe pas dhënies së pëlqimit nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe pëlqimit paraprak nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e tregtisë dhe Industrisë.

Së dyti, vendimi është thirrur në Ligjin Nr. 03/L-090 mbi partneritetet publiko privat dhe koncesionet në infrastrukturë dhe procedurat për dhënien e tyre. Nëse i’u referohemi dispozitave të këtij ligji, atëherë kërkesa e drejtuar kuvendit të komunës së Rahovecit ka të bëjë me një propozim të pa kërkuar nga autoriteti kontraktues (komuna). Për zbatimin e kësaj kërkesë komuna duhet të respektoj dispozitat e nenit 38, 39 dhe 40 të këtij ligji. Gjithashtu, në këtë ligj parashihet që për aprovimin e kërkesave (propozimeve) duhet të inicohet procedura tenderuese pas aprovimit të KDNM-PPP (organ përgjegjës për kontrollimin dhe koordinimin e Projekteve të PPP) dhe pas kësaj të inicohet procedura konkurruese e përzgjedhjes sipas neneve 23 deri 25 të po të njëjtit ligj. Këtij vendimi ende nuk i është bërë vlerësimi i ligjshmërisë nga organi mbikëqyrës. Kjo mund të realizohet pas procedimit nga komuna për shqyrtim administrativ, andaj deri në shqyrtimin e ligjshmërisë nuk mund të konsiderohet akt me fuqi të plotë

² Vlerësim *prima facie* nga zyrtari monitorues

juridike. Ndërsa, Kuvendi i Komunës së Rahovecit me një Vendim tjetër, kompanisë NPHT "Gastro-Kos" nga Prishtina, i ka vazhduar kontratën për shfrytëzimin e Hotelit "Park" në Rahovec edhe për gjashtë muaj, megjithë skadimin e kontratës. Mundësia e vazhimit të kontratës shfrytëzuesve të pronës komunale nuk është përcaktuar me Ligjin nr.03/L-226 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës. Ndër aktet e tjera të miratuara nga Kuvendi i Komunës, të cilat po ashtu nuk janë përcjellë për shqyrtim administrativ në MAPL bënë pjesë edhe Rregullorja për shërbimet publike komunale dhe emergjencë. Përveç, kësaj është miratuar gjithashtu Rregullorja për organizimin e punës dhe të mësimin në shkollat e mesme të larta në Komunën e Rahovecit. Në këtë mbledhje gjithashtu është ndryshuar përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa, meqenëse ka pasur lëvizje të kuvendarëve nga një subjekt politik në tjetrin, dhe për shkak të zgjedhjes së kryesuesit të ri të Kuvendit.

Gjetjet më të rëndësishme

- Komuna e Deçanit, Junikut dhe Rahovecit edhe në këtë periudhë nuk kanë respektuar dispozitat e nenit 80 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Komunitat nuk kanë sjellë aktet për shqyrtim të ligjshmërisë.
- Në kuvendin e Komunës së Rahovecit nga zyrtari monitorues janë evidentuar disa raste të shkeljeve ligjore, për të cilat pritet vlerësimi përfundimtar nga Departamenti Ligjor i MAPL-së. Në shumicën e rasteve, Kuvendi i komunës vendimet i nxjerr të titulluara si Aktvendime. Kuvendi i Komunës nuk është organ kompetent për nxjerrjen e Aktvendimeve. Aktet të cilat mund t'i nxjerr Kuvendi i Komunës janë aktet e përcaktuara në nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.
Natyra e akteve të kontestuara kryesisht ka të bëjë me pretendimet e komunës për të kthyer në pronësi komunale pronat të cilat menaxhon AKP.
Po ashtu, kemi vërejtur mosrespektim dispozitave të Ligjit nr.03/L-226 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe Ligjit Nr. 03/L-090 mbi partneritetet publiko-private dhe koncesionet në infrastrukturë dhe procedurat për dhënien e tyre.
- Kuvendi i Komunës së Gjakovës ka bërë shkelje të Ligjit nr.03/L-226 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me rastin e miratimit të kërkesës së një qytetari për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme. Për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale kërkohet respektimi i kritereve të përcaktuara me Ligjin për Prokurimin Publik.
- Komuna e Junikut dhe Deçanit kanë shpallur gjendje të jashtëzakonshme, veprim që bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
- Në asnjërën prej komunave nuk janë themeluar komitetet konsultative.

KOMUNAT: GJILAN, PRIZREN, KAMENICË, NOVOBËRDË DHE RANILLUG

Mbledhjet e mbajtura

Në këtë pjesë të raportit pasqyrohet gjendja reale e funksionimit të Kuvendeve të Komunave për periudhën janar-mars 2012, si: **Gjilan, Prizren, Kamenicë, Novobërdë dhe Ranillug.**

Monitorimi i mbledhjes së Kuvendeve të Komunave është bërë përmes sistemit të teleprezencës. Kjo mënyrë e monitorimit dhe e komunikimit ka mundësuar një lidhje direkte me Kuvendin. Lidhja e realizuar ka qenë e shkëlqyeshme qoftë për nga transmetimi i zërit, po ashtu edhe për nga pamjet vizuale të shfaqura si video.

Kuvendet e këtyre komunave kanë funksionuar normalisht, por me disa vërejtje të evidentuara gjatë monitorimit të tyre. Këtë çështje do ta elaborojmë për secilën Komunë veç e veç në fushën që ka të bëjë me përmbledhjen nga mbledhjet e Kuvendit. Në çështjen e mbarëvajtjes së mbledhjeve të rregullta dhe funksionimit të punës së tyre, kuvendet e komunave në një masë të madhe kanë respektuar ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës. Gjatë periudhës së tremujorit të parë të vitit 2012, në Komuna vërehet një organizim më i mirë në planifikimin e aktiviteteve, orarin e takimeve, si dhe në miratimin e planeve vjetore të punës. Sa i përket aspektit kuantitativ, kuvendet e komunave kanë përmbushur obligimin ligjor në mbajtjen e mbledhjeve si dhe me kohë e kanë njoftuar MAPL-në për mbajtjen e tyre, duke respektuar procedurat dhe afatet e njoftimeve. Kurse, sa i përket aspektit kualitativ, Komunat kanë ngritur shkallën e dëshiruar në çështjet procedurale dhe në procesin e punës duke respektuar Rregulloren e punës së Kuvendit.

Sa i përket rendit të ditës, pothuajse në shumicën e rasteve, mbledhjet kanë filluar dhe janë zhvilluar në bazë të këtij rendi. Të gjitha mbledhjet e Kuvendeve të Komunave kanë qenë të hapura për publikun, ndërsa me qëllim të rritjes së transparencës komunale, në shumicën e komunave është mundësuar transmetimi direkt apo indirekt i mbledhjeve, nga televizionet lokale. Përveç kësaj, Komunat informimin e bëjnë edhe përmes ueb-faqes zyrtare, buletinit, informimit publik, nxjerrjes së përmbledhjeve të akteve komunale. Në shumicën prej tyre kanë marrë pjesë përfaqësuesit e OSBE-së, ICO-së, KFOR-it, USAID-it, DEM-it, OJQ-të e ndryshme, mediet dhe qytetarët e interesuar. Përgjithësisht, interesimi i qytetarëve ka qenë i kënaqshëm, mirëpo jo me trend të rritjes.

Gjatë periudhës janar - mars 2012, Kuvendet e Komunave kanë mbajtur gjithsej 14 mbledhje. Kuvendi i Komunës së Gjilanit, Kamenicës, Novobërdës dhe Ranillugut kanë mbajtur nga 3 mbledhje të rregullta, ndërsa Kuvendi i Komunës së Prizrenit ka mbajtur 2 mbledhje të rregullta.




Fig. 4. Numri i mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave: Gjilan, Prizren, Kamenicë, Novobërdë dhe Ranillug

Komitetet obligative dhe komitetet e tjera kanë qenë funksionale për periudhën janar - mars 2012. Në Kuvendin e Komunës së Gjilanit dhe atë të Ranillugut, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 3 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur 2 mbledhje, në Kuvendin e Komunës së Prizrenit, KPF dhe KK kanë mbajtur nga 2 mbledhje, në Kuvendin e Komunës së Kamenicës, KPF dhe KK kanë mbajtur nga 3 mbledhje, në Kuvendin e Komunës së Novobërdës, KPF ka mbajtur 3 mbledhje kurse KK vetëm 1 mbledhje.




Fig. 5. Numri i mbledhjeve të Komiteteve të obligueshme: Gjilan, Prizren, Kamenicë, Novobërdë dhe Ranillug

Sa i përket Komiteteve Konsultative, Komuna e Gjilanit, Prizrenit, Kamenicës, Novobërdës dhe Ranillugut, ende nuk i kanë të themeluara këto Komitete.

Sa u përket akteve komunale, janë miratuar gjithsej 80 akte komunale, prej tyre 72 vendime dhe 8 rregullore.




Fig. 6. Numri i akteve komunale të miratuara në Kuvendet e Komunave: Gjilan, Prizren, Kamenicë, Novobërdë dhe Ranillug

Në miratimin e akteve komunale, më aktive janë treguar Kuvendi i Komunës së Gjilanit dhe Prizrenit me gjithsej 40 akte komunale të miratuara, prej tyre me nga 18 vendime dhe 2 rregullore të miratuara, pastaj Kuvendi i Komunës së Novobërdës me 17 vendime dhe 2 rregullore, Kuvendi i Komunës së Ranillugut me 10 vendime dhe 1 rregullore dhe në fund, Kuvendi i Komunës së Kamenicës me 9 vendime dhe 1 rregullore të miratuara.

Me qëllim të forcimit të transparencës dhe krijimit të hapësirës që qytetarët të jenë pjesë e vendimmarrjes, Komunitat për këtë periudhë raportuese kanë mbajtur takime publike me qytetarë por me një rënie të lehtë të mbajtjes së tyre. Në këtë drejtim, në periudhën janar – mars 2012, Komuna e Gjilanit, Novobërdës dhe Ranillugut kanë mbajtur nga 1 takim publik me qytetarë, ndërsa Komuna e Prizrenit dhe Kamenicës nuk kanë mbajtur asnjë takim publik me qytetarë.

LVL-ja, përkatësisht neni 58 pika j, parasheh që Kryetari i Komunës të raportoj para Kuvendit të Komunës së paku një herë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës. Në këtë periudhë raportuese, Kryetari i Komunës së Gjilanit, Novobërdës dhe Ranillugut kanë raportuar nga 1 herë para Kuvendit të Komunës.

Lidhur me Këshillat Lokale për Siguri në Bashkësi, periudha janar – mars 2012 rezulton me këto të dhëna: Komuna e Gjilanit, Prizrenit dhe Novobërdës kanë mbajtur nga 1 mbledhje, ndërsa Komuna e Kamenicës dhe Ranillugut nuk kanë mbajtur asnjë mbledhje.




Fig. 7. Numri i takimeve të KKSB-ve në komunitat: Gjilan, Prizren, Kamenicë, Novobërdë dhe Ranillug.

Përmbledhje nga mbledhjet e kuvendeve

Gjilan

Mbledhja e parë e Kuvendit të Komunës për vitin 2012 është mbajtur në muajin shkurt. Komuna e Gjilanit gjatë periudhës janar-mars 2012 ka mbajtur gjithsej 3 mbledhje të rregullta të Kuvendit të Komunës. Ndërsa, sa i përket Komiteteve Obligative, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 3 mbledhje, kurse Komiteti për Komunitete ka mbajtur 2 mbledhje. Kuvendi i Komunës së Gjilanit ka përmbushur obligimin ligjor sa i përket mbajtjes së mbledhjeve dhe se me kohë e ka njoftuar MAPL-në për mbajtjen e tyre, duke respektuar procedurat dhe afatet e njoftimeve. Aktet të cilat janë miratuar në kuvend, dërgohen me kohë në adresë të MAPL-së. Mbledhjet kanë qenë transparente dhe të hapura për publikun. Pjesëmarrja e organizatave ndërkombëtare dhe lokale, medieve, qytetarëve të interesuar ka qenë e kënaqshme. Në të gjitha mbledhjet e kuvendit ka pasur kuorum për mbajtjen e tyre. Periudha janar - mars 2012 karakterizohet me një koherencë në volumin e punës duke rezultuar me miratimin e akteve të ndryshme, qoftë për nga prioritetet po ashtu edhe për nga rëndësia e tyre. Në marrjen e vendimeve ka pasur kuorum. Në mbledhjet e Kuvendit është zhvilluar një klimë konstruktive në mes të grupeve parlamentare gjatë zhvillimit të diskutimeve. Në këtë periudhë është bërë zëvendësimi i 2 anëtarëve të Kuvendit me 2 anëtar të rinj, për shkak se anëtari i parë i kuvendit ka shkuar jashtë vendit për studime master, ndërsa i dyti është bërë drejtor për zhvillim ekonomik. Duhet përmendur se Kuvendi i Komunës së Gjilanit ka miratuar planin vjetor të punës së Kuvendit dhe orarin e takimeve, planin e veprimit për mobilitet, planin e veprimit për ndriçim publik.

Një nga përgjegjësit e kryetarit të Komunës është edhe raportimi i tij para kuvendit të Komunës së paku një herë në gjashtë muaj ose kurdo herë që kërkohet. Në këtë drejtim, kryetari ka raportuar 1 herë në muajin mars para Kuvendit të Komunës.

Në muajin janar të vitit 2012, Agjencia Kundër Korrupsionit kishte dërguar një kërkesë në Gjykatën për Kundërvajtje në Gjilan, për fillimin e procedurës kundërvajtëse, ndaj Kryetarit të Komunës së Gjilanit, z. Qemajl Mustafa për shkak të, siç thuhet "konfliktit të interesit", ngase kryetari është njëri nga pronarët e kompanisë biznesore private "Frutta Viva". Mirëpo, Kryetari i Komunës së Gjilanit, z. Qemajl Mustafa ka ndërmarrë hapin për shuarjen e aktivitetit të tij biznesor edhe juridikisht, si aksionar (ligjor) në kompaninë biznesore private "Frutta Viva" sh.p.k. për t'i hequr përfundimisht të gjitha dilemat dhe spekulimet që ishin ngritur rreth tij, për "konflikt të interesit" me funksionin e tij publik si Kryetar i Komunës në njërën anë dhe në anën tjetër duke qenë të njëjtën kohë edhe njëri prej pronarëve të këtij biznesi, e që në të vërtetë ishte fiktiv dhe kishte zero qarkullim.

Lidhur me numrin e mbajtjes së mbledhjeve të KKS-ve, në Komunën e Gjilanit ky Këshill ka mbajtur vetëm 1 mbledhje për periudhën janar - mars të vitit 2012.

Aktet më të rëndësishme

Sa i përket akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Gjilanit ka miratuar 18 vendime dhe 2 rregullore. Ndër aktet komunale më të rëndësishme të cilat janë marrë gjatë kësaj periudhe janë:

- 1.Vendim për aprovimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të kuvendit dhe komiteteve të KK-së Gjilan për vitin kalendarik 2012. Me këtë Vendim është bërë aprovimi i orarit të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit dhe Komiteteve të KK-së Gjilan për vitin kalendarik 2012.
- 2.Vendim për miratimin e planit të veprimit për përmirësimin e shërbimit të mobilitetit dhe transportit publik në qytetin e Gjilanit. Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Gjilanit e ka miratuar këtë Plan të Veprimit me të cilin parasheh të bëjë përmirësimin e shërbimit të mobilitetit dhe transportit publik në qytetin e Gjilanit.
3. Vendim për miratimin e planit të veprimit për ndriçim publik në Komunën e Gjilanit. Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Gjilanit miraton Planin e Veprimit për ndriçim publik në Komunën e Gjilanit.
- 4.Rregullore për ndarjen e subvencioneve. Me këtë Rregullore, janë përcaktuar kriteret dhe procedurat e ndarjes së mjeteve të buxhetit të Komunës- fondi për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale, personave fizik dhe juridik.

Prizren

Edhe Komuna e Prizrenit ashtu sikurse Komuna paraprake, mbledhjen e parë të Kuvendit e ka filluar në muajin shkurt të vitit 2012. Në periudhën janar – mars 2012, Kuvendi i Komunës së Prizrenit ka mbajtur 2 mbledhje të rregullta. Sa i përket Komiteteve Obligative, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 2 mbledhje, po aq ka mbajtur edhe Komitetit për Komunitete. Lidhur me procedurat, afatet e njoftimeve dhe dërgimin e materialit, Kuvendi i Komunës e ka përmbushur këtë obligim ligjor ndaj MAPL-së. Aktet komunale dërgohen me kohë në MAPL, mirëpo këto akte komunale janë të pa nënshkuara nga Kryesuesi i Kuvendit, të pa protokolluara dhe të pa vulosura. Kurse, sa i përket rendit të ditës, ka pasur rast kur brenda një pikës së rendit të ditës janë miratuar dy vendime, pa qenë ajo pikë pjesë e rendit të ditës dhe pa u futur në rend të ditës për miratim. Po ashtu, kryesuesi i Kuvendit para çdo vendimi të marrë ka verifikuar se a ka kuorum. Grupet parlamentare kanë treguar konstruktivitet, mirëkuptim dhe respektim të fjalës dhe debatit gjatë punimeve në Kuvend, mirëpo shpesh është vërejtur që një pjesë e anëtarëve të kuvendit kanë lëvizur nga salla e mbledhjes duke hyrë dhe dal e që me këtë kanë lënë të kuptohet për mos seriozitet të punës së Kuvendit.

Mbledhjet kanë qenë transparente dhe të hapura për publikun, në to kanë marrë pjesë OSCE, USAID-DEMI, OJQ, KFOR, ICO, mediet, si dhe qytetarë të interesuar.

Lidhur me numrin e mbajtjes së mbledhjeve të KKSB-ve, në Komunën e Prizrenit ky Këshill ka mbajtur vetëm 1 mbledhje për periudhën janar – mars të vitit 2012.

Aktet më të rëndësishme

Në miratimin e akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Prizrenit është treguar aktiv me gjithsej 20 akte komunale të miratuara, prej tyre 18 vendime dhe 2 rregullore.

Ndër aktet komunale më të rëndësishme të cilat janë marrë gjatë kësaj periudhe janë:

1. Vendim për Planin e Punës së Kuvendit për vitin 2012. Me këtë vendim, Kuvendi ka miratuar planin e punës së Kuvendit për vitin 2012.
2. Rregullore për transparencën komunale. Kuvendi i Komunës së Prizrenit ka miratuar rregulloren për transparencë komunale.
3. Vendim mbi shpalljen e interesit të përgjithshëm. Me këtë vendim është aprovuar propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Drejtoria e Administratës-Sektorit i Pronës dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, për shpalljen e interesit të përgjithshëm shoqëroro-publik për realizimin e projektit të ndërtimit të impiantit të ujërave të zeza të qytetit të Prizrenit në fshatin Vlashnje.
4. Rregullore për përdorimin e gjuhëve. Kjo Rregullore ka për qëllim të sigurojë përdorimin e gjuhëve zyrtare në pajtim me dispozitat e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, në punën e administratës komunale, në institucionet arsimore dhe shëndetësore që themelohen apo qeverisen nga Komuna dhe në ndërmarrjet publike lokale të themeluara nga Komuna.

Kamenicë

Gjatë periudhës janar-mars të vitit 2012, Kuvendi i Komunës së Kamenicës ka mbajtur 3 mbledhje të rregullta. Kurse, sa i përket Komiteteve Obligative, KPF dhe KK kanë mbajtur nga 3 mbledhje. Në çështjet procedurale, afatet e njoftimeve, dërgimin e ftesës dhe materialit të mbledhjes së Kuvendit, Kuvendi i Komunës së Kamenicës ka përmbushur këtë obligim ligjor në raport me MAPL-në. Po ashtu, Kuvendi i Komunës së Kamenicës ka dërguar me kohë aktet komunale në adresë të MAPL-së. Sa i përket rendit të ditës, mbledhjet e Kuvendit kanë filluar me kohë dhe i janë përmbajtur këtij rendi, mirëpo duhet përmendur se në mbledhjen e tretë të Kuvendit, anëtarët e kuvendit nga radhët e PDK-së kërkuan që informata e ofruar mbi ndarjen e bursave për student të jetë më e kompletuar edhe me të dhëna të tjera. Ata kërkuan që informata të silltet brenda mbledhjes së kuvendit, mirëpo drejtoresha e arsimit është përgjigjur se një gjë e tillë nuk mund të kompletohet brenda ditës. Për shkak të mos

përmbushjes së kërkesës nga ana e drejtoreshës, në shenjë pakënaqësie dhe revolte, anëtarët e kuvendit nga radhët e PDK-së e kanë braktisur mbledhjen e Kuvendit.

Lidhur me transparencën komunale, mbledhjet kanë qenë të hapura për publikun dhe në to kanë marrë pjesë përfaqësuesit e OSBE-së, USAID-DEMI, OJQ, mediet dhe qytetarë të interesuar.

Sa i përket numrit të mbajtjes së mbledhjeve të KKS-së, në Komunën e Kamenicës ky Këshill nuk ka mbajtur asnjë mbledhje për periudhën janar - mars të vitit 2012.

Aktet më të rëndësishme

Nga aspekti kuantitativ i miratimit të akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Kamenicës ka miratuar gjithsej 10 akte komunale, prej tyre 9 vendime dhe 1 rregullore. Aktet më të rëndësishme komunale të cilat janë marrë gjatë kësaj periudhe janë:

1. Rregullore për organizimin e brendshëm të administratës komunale në Komunën e Kamenicës. Kjo Rregullore përcakton organizimin e brendshëm të administratës komunale të Komunës së Kamenicës.
2. Vendim për miratimin e raportit të buxhetit për vitin 2011. Me këtë vendim është miratuar raporti i buxhetit për vitin 2011.

Novobërdë

Kuvendi i Komunës së Novobërdës gjatë periudhës raportuese ka mbajtur 3 mbledhje të rregullta. Ndërsa, lidhur me Komitetet Obligative, KPF ka mbajtur 3 mbledhje, kurse KK vetëm 1 mbledhje. Duhet përmendur se Kuvendi i Komunës së Novobërdës është treguar i vëmendshëm në respektimin e procedurave, afatin e njoftimeve, dërgimin me kohë të ftesës dhe materialit të mbledhjes së Kuvendit, si dhe në dërgimin e akteve komunale në drejtim të MAPL-së. Mbledhjet e Kuvendit fillojnë me kohë dhe kryesisht i përmbahen rendit të ditës. Gjatë monitorimit të mbledhjeve është vërejtur se në fillim të mbledhjes nuk bëhet konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit, edhe pse në të gjitha mbledhjet e Kuvendit ka kuorum për marrjen e vendimeve. Kuvendi i Komunës së Novobërdës ka miratuar planin vjetor të punës së Kuvendit. Në mbledhjet e Kuvendit ende vërehet praktika e zgjatjes së fjalimeve dhe e mos respektimit të minutazhit kohor. Në përgjithësi, grupet parlamentare zhvillojnë debat të hapur në të gjitha çështjet që diskutohen në Kuvend. Sa i përket transparencës komunale, mbledhjet e Kuvendit janë të hapura për publikun dhe në të marrin pjesë përfaqësues të organizatave ndërkombëtare por edhe të atyre vendore, mediet, si dhe qytetarë të interesuar.

Një nga përgjegjësit e kryetarit të Komunës është edhe raportimi i tij para kuvendit të Komunës së paku një herë në gjashtë muaj ose kurdo herë që kërkohet. Në këtë drejtim, kryetari ka raportuar 1 herë në muajin janar para Kuvendit të Komunës.

Lidhur me numrin e mbajtjes së mbledhjeve të KKSB-ve, në Komunën e Novobërdës ky Këshill ka mbajtur vetëm 1 mbledhje për periudhën janar – mars të vitit 2012.

Aktet më të rëndësishme

Në periudhën janar – mars të vitit 2012, Kuvendi i Komunës së Novobërdës ka miratuar akte të ndryshme komunale. Më tej, në bazë të dhënave që posedojmë del se janë miratuar gjithsej 18 akte komunale, prej tyre 16 vendime dhe 2 rregullore.

Aktet më të rëndësishme komunale të cilat janë marrë gjatë kësaj periudhe janë:

1. Vendim mbi miratimin e raportit financiar vjetor për vitin 2011-të. Me këtë vendim është miratuar raporti financiar vjetor për vitin 2011-të;
2. Rregullore për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Novobërdës. Kjo Rregullore, ka për qëllim të rregullojë organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës, në ushtrimin e aktiviteteve që janë ekskluzivisht në kompetencë vetanake të komunave, të përcaktuara në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.
3. Vendim për lirim nga tarifat, ngarkesat komunale për bizneset individuale. Me këtë vendim, bizneset prodhuese lirohen nga tarifat dhe ngarkesat komunale për një periudhë 5 vjeçare duke filluar nga 1 janari i vitit 2012, bizneset prodhuese dhe joprodhuese të cilat regjistrohen nga 1 janari i vitit 2012 lirohen nga tarifat dhe ngarkesat komunale për një periudhë 3 vjeçare, ndërsa bizneset joformale të cilat regjistrohen deri në fund të muajit mars të vitit 2012 lirohen nga taksat dhe ngarkesat komunale për një periudhë 2 vjeçare.

Ranillug

Gjatë periudhës janar – mars të vitit 2012, Kuvendi i Komunës së Ranillugut është mbledhur gjithsej 3 herë. Po ashtu, edhe tek Komitetet Obligative, përkatësisht atë të KPF-së dhe KK-së ka mbajtur nga 3 mbledhje. Në mbledhjen e muajit janar, Kuvendi i Komunës së Ranillugut përmes vendimit të marrë ka plotësuar KPF-në me dy anëtarë. Kuvendi i Komunës së Ranillugut materialin e mbledhjes së Kuvendit e dërgon me kohë, mirëpo materiali i ardhur nuk është i përkthyer edhe në gjuhën shqipe. Në këtë drejtim, nuk është respektuar plotësisht neni 43.4 i LVL-së, ndërsa njoftimi për mbledhje është në pajtim me nenin 43.4 dhe 43.5 të LVL-së. Kurse, sa i përket dërgimit të akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Ranillugut i përmbahet obligimit ligjor duke dërguar me kohë aktet komunale në drejtim të MAPL-së. Lidhur me ecurinë e

mbajtjes së mbledhjes së Kuvendit, Kuvendi i Komunës së Ranillugut në përpikëri e respekton rregulloren e punës së Kuvendit. Çështja e kohës së fillimit të mbledhjes, rendit të ditës, konstatimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit, verifikimit të kuorumit para marrjes së vendimit është në përputhje me obligimet e dala ligjore. Të gjitha mbledhjet e Kuvendit janë transparente dhe të hapura për publikun, ku në to pjesëmarrës të rregullt janë OSBE, USAID-DEMI, UNDP, KFOR, OJQ, mediet dhe qytetarë të interesuar. Gjatë zhvillimit të punimeve në Kuvend, grupet parlamentare tregojnë një klimë të bashkëpunimit, diskutimit të hapur por edhe të dhënies së kritikave brenda për brenda Kuvendit.

Një nga përgjegjësit e kryetarit të Komunës është edhe raportimi i tij para kuvendit të Komunës së paku një herë në gjashtë muaj ose kurdo herë që kërkohet. Në këtë çështje, kryetari ka raportuar 1 herë gjatë tre mujorit të parë para Kuvendit të Komunës.

Në muajin shkurt të vitit 2012, nënkryetari i Komunës së Ranillugut z. Nebojsa Keniç ka dhënë dorëheqje nga pozita e mbajtur, si dhe nga funksionet tjera që ka patur në Komunë. Kryetari i Komunës së Ranillugut z. Gradimir Mikiç ka bërë zëvendësimin e menjëhershëm duke e emëruar z. Titomir Steviç për nënkryetar të Komunës së Ranillugut.

Lidhur me numrin e mbajtjes së mbledhjeve të KKSBB-ve, në Komunën e Ranillugut ky Këshill nuk ka mbajtur asnjë mbledhje për periudhën janar – mars të vitit 2012.

Aktet më të rëndësishme

Gjatë periudhës janar – mars të vitit 2012, Kuvendi i Komunës së Ranillugut ka miratuar gjithsej 11 akte komunale, prej tyre 10 vendime dhe 1 rregullore.

Aktet më të rëndësishme komunale të cilat janë marrë gjatë kësaj periudhe janë:

1. Vendim mbi planin akcional për përmirësimin e shërbimeve të Komunës së Ranillugut. Ky vendim parasheh përmirësimin e shërbimeve të Komunës së Ranillugut të ndara në shërbime të ndryshme sipas planit akcional;
2. Rregullore mbi organizimin, dhe bashkëpunimin me fshatrat e komunës, zonat urbane dhe vendbanimet urbane në Komunën e Ranillugut. Kjo Rregullore ka për qëllim të rregullojë organizimin dhe bashkëpunimin ndërmjet komunave dhe fshatrave, vendbanimeve dhe vendbanimeve urbane në qytet, në kryerjen e aktiviteteve që bien nën juridiksionin ekskluziv të komunës së tyre, bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale.

Të gjeturat

- Në Kuvendin e Komunës së Gjilanit është evidentuar një shkelje ligjore me rastin e miratimit të Vendimit për plotësimin e rregullores për taksa dhe gjoba komunale. Në këtë rast është konstatuar se ky Vendim është në kundërshtim me nenin 12 të LVL si dhe nenin 7 pika 1 të U.A 2008/09.
- Në Kuvendin e Komunës së Gjilanit, në këtë periudhe raportuese është bërë zëvendësimi i 2 anëtarëve të Kuvendit me 2 anëtar të rinj, për shkak se anëtari i parë i kuvendit ka shkuar jashtë vendit për studime master, ndërsa i dyti është bërë drejtor për zhvillim ekonomik.
- Në Kuvendin e Komunës së Prizrenit është evidentuar një rast kur brenda një pikës së rendit të ditës janë miratuar dy vendime, pa qenë ajo pikë pjesë e rendit të ditës dhe pa u futur në rend të ditës për miratim.
- Komuna e Prizrenit, aktet komunale i dërgon me kohë në adresë të MAPL-së, mirëpo këto akte komunale janë të pa nënshkruara nga Kryesuesi i Kuvendit, të pa protokolluara dhe të pa vulosura.
- Komuna e Prizrenit, ka miratuar Rregulloren për transparencë.
- Është evidentuar një rast i braktisjes së mbledhjes së tretë të Kuvendit të Komunës së Kamenicës nga grupi parlamentar i PDK-së. Mbledhja është braktisur për shkak të mos përmbushjes së kërkesës së tyre lidhur me plotësimin informatës së ofruar nga drejtoresha e arsimit në çështjen e ndarjes së bursave për student.
- Gjatë tre mujorit të parë të vitit 2012, në Komunën e Kamenicës dhe të Ranillugut, KKSB nuk ka mbajtur asnjë mbledhje.
- Në mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Novobërdës është konstatuar se nuk bëhet konstatimi i prezencës së anëtarëve të kuvendit.
- Kuvendi i Komunës së Ranillugut materialin e mbledhjes së Kuvendit e dërgon me kohë, mirëpo materiali i ardhur nuk është i përkthyer edhe në gjuhën shqipe. Në këtë drejtim, nuk është respektuar plotësisht neni 43.4 i LVL-së.
- Në muajin shkurt të vitit 2012, nënkryetari i Komunës së Ranillugut z. Nebojsa Keniç ka dhënë dorëheqje nga pozita e mbajtur, si dhe nga funksionet tjera që ka patur në Komunë. Kryetari i Komunës së Ranillugut z. Gradimir Mikiç ka bërë zëvendësimin e menjëhershëm duke e emëruar z. Titomir Steviç për nënkryetar të Komunës së Ranillugut.
- Në asnjërën prej komunave nuk janë themeluar komitetet konsultative.

KOMUNAT: PEJË, KLINË, ISTOG, MALISHEVË DHE SUHAREKË

Mbledhjet e mbajtura

Gjatë periudhës janar – mars të vitit 2012, rrjedha e punës së Kuvendeve të Komunave: **Pejë, Klinë, Istog, Malishevë dhe Suharekë** ka qenë funksionale.

Në këtë drejtim, për këtë periudhë raportuese, Kuvendet e këtyre Komunave kanë mbajtur gjithsej 15 mbledhje të rregullta, ndërsa sa i përket mbledhjeve të jashtëzakonshme nuk kanë mbajtur.

Ajo që vlen të potencohet është se, në këtë fillim vit, monitorimi i mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave është bërë përmes sistemit të teleprezencës.




Fig. 8. Numri i mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave: Pejë, Klinë, Istog, Malishevë dhe Suharekë

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2011, del se numri i mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të këtyre Kuvendeve në vitin 2012 është më i madh.

Në përgjithësi, Komunitat e lartcekura kanë dërguar me kohë ftesën për mbledhje. Komitetet obligative dhe komitetet e tjera kanë qenë funksionale për periudhën janar – mars 2012. Në Kuvendin e Komunës së Pejës, Klinës dhe Istogut, KPF dhe KK kanë mbajtur nga 3 mbledhje, në Kuvendin e Komunës së Malishevës, KPF ka mbajtur 3 mbledhje, ndërsa KK 1 mbledhje, kurse në Kuvendin e Komunës së Suharekës KPF ka mbajtur 3 mbledhje, ndërsa KK 2 mbledhje.




Fig. 9. Numri i mbledhjeve të Komiteteve të obligueshme: Pejë, Klinë, Istog, Malishevë dhe Suharekë

Duhet potencuar faktin se në Komunën e Malishevës, Komiteti për Komunitete gjatë kësaj periudhe ka funksionuar pjesërisht duke mbajtur vetëm një mbledhje.

Në periudhën janar-mars të vitit 2012, në komunat e lartpërmendura është miratuar Raporti i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2012. Lidhur me këtë, nuk munguan vërejtjet e kuvendarëve për shumë çështje që kishin të bënin me punën e kryetarit të komunës dhe drejtorive përkatëse.

Duke ju referuar monitorimit të mbledhjeve të kuvendeve dhe analizimit të dokumenteve të ndryshme, Kuvendet e Komunave: Pejë, Klinë, Istog, Malishevë dhe Suharekë kanë zhvilluar veprimtarinë e tyre normalisht. Kuvendet kanë miratuar vendime me rëndësi dhe me interes për qytetarët.




Fig. 10. Numri i akteve komunale të miratuara në Kuvendet e Komunave: Pejë, Klinë, Istog, Malishevë dhe Suharekë

Gjatë kësaj periudhe të raportimit, Komunat kanë miratuar gjithsej 64 vendime dhe 3 rregullore.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2011, në vitin 2012, Kuvendet e këtyre Komunave kanë miratuar numër më të madh të vendimeve, ndërsa, sa i përket numrit të Rregulloreve të miratuara gjatë periudhës janar-mars 2012, gjendja është e njëjtë me periudhën e vitit të kaluar.

Në periudhën janar-mars të vitit 2011, Kuvendet e këtyre Komunave kishin miratuar gjithsej 40 vendime dhe 3 rregullore.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është funksional në Komunën e Pejës, Klinës, Istogut, Malishevës dhe Suharekës. Në këtë periudhë, ky Këshill, në Komunën e Pejës dhe të Malishevës ka mbajtur vetëm nga 1 mbledhje, në Komunën e Klinës dhe Suharekës nga 2 mbledhje të mbajtura, kurse në Komunën e Istogut me më së shumti mbledhje të mbajtura 3.

Sipas të dhënave, këto këshilla në këtë periudhë kanë mbajtur këtë numër të takimeve:




Fig. 11. Numri i takimeve të KKSJ-ve në komunat: Pejë, Klinë, Istog, Malishevë dhe Suharekë.

Përmbledhje nga mbledhjet e kuvendeve

Malishevë

Gjatë periudhës janar-mars të vitit 2012, Kuvendi i Komunës së Malishevës ka funksionuar normalisht. Ftesat për mbledhje janë dërguar me kohë në Ministrinë përgjegjëse konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Në këtë periudhë të raportimit Kuvendi i Komunës së Malishevës ka mbajtur gjithsej 3 mbledhje të rregullta. Monitorimi i mbledhjeve të Kuvendit është bërë përmes sistemit të teleprezencës.

Në mbledhjen e thirrur në muajin mars, opozita e kësaj Komune ka lëshuar mbledhjen e kuvendit, për shkak se nuk është marrë parasysh kërkesa e tyre për shtyrjen e një pike të rendit të ditës që ishte paraparë për atë mbledhje. Në mungesë të kuorumit, Kryesuesi i Kuvendit e shtyu mbledhjen për muajin prill.

Gjatë tri mbledhjeve të mbajtura në këtë tre-mujor të vitit 2012, Kuvendi i Komunës së Malishevës ka miratuar gjithsej 9 vendime.

Mbledhjet kanë qenë transparente dhe të hapura për publikun. Në mbledhje kanë qenë prezent edhe përfaqësues të: KFOR-it, OSBE-së, OJQ-ve, mediet, si dhe qytetarët e interesuar etj.

Në këtë komunë, Komiteti për Politikë dhe Financa ka qenë funksional dhe ka mbajtur 3 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka funksionuar pjesërisht dhe se gjatë kësaj periudhe ka mbajtur vetëm 1 mbledhje.

Në Komunën e Malishevës janë themeluar edhe këto Komitete të tjera:

Komiteti i Diasporës, Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalid dhe Veteranë të Luftës së UÇK-së, si dhe Komitetit për Shëndetësi dhe Çështje Sociale.

Në periudhën janar-mars të vitit 2012, në komunën e lartcekur është miratuar edhe Raporti i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2011. Lidhur me këtë raport, nuk kanë munguar vërejtjet e kuvendarëve për shumë çështje që kishin të bënin me punën e kryetarit të komunës dhe drejtorive përkatëse.

Po ashtu, Kuvendi i Komunës së Malishevës ka miratuar Planin e Punës së Kuvendit për vitin 2012, ky plan është hartuar nga një Komision i themeluar nga Kuvendi i Komunës.

Aktet më të rëndësishme

Në kuadër të aktivitetit të saj, Kuvendi i Komunës së Malishevës gjatë tre-mujorit të parë të vitit 2012 ka miratuar gjithsej 9 vendime ndërsa rregullore nuk ka miratuar. Ndër aktet komunale më të rëndësishme të cilat janë marrë gjatë kësaj periudhe janë:

- 1.Vendim për ndarjen e një sipërfaqe tokësore, për qëllim të rregullimit të varrezave publike të Qytezës së Malishevës.
- 2.Vendim në lidhje me kërkesën e Këshillit të Bashkësisë Islame në Malishevë nr.01/119 datë 11.01.2012, për ndarjen e një sipërfaqe tokësore, për ndërtimin e Xhamisë në fshatin Drenoc.
- 3.Vendim për shfuqizimin e vendimit nr.01/205 datë 23.03.2004 për shpalljen e zonës së veçantë dhe caktimin e lokacionit për ndërtimin e shtëpisë së kulturës.
- 4.Vendim mbi miratimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2012.

Pejë

Në periudhën janar – mars të vitit 2012, Kuvendi i Komunës së Pejës ka funksionuar normalisht dhe tesën për mbledhje e ka dërguar konform LVL-së. Gjatë kësaj kohe, Kuvendi i Komunës së Pejës ka mbajtur 3 mbledhje të rregullta, në të cilat mbledhje janë miratuar gjithsej 17 vendime, ndërsa sa i përket mbledhjeve të jashtëzakonshme nuk ka mbajtur.

Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit ka qenë i pranishëm edhe Kryetari i Komunës. Edhe në këtë Komunë, monitorimi i mbledhjeve të Kuvendit është bërë përmes sistemit të teleprezencës.

Mbledhjet kanë qenë transparente dhe të hapura për publikun. Në mbledhje kanë qenë prezent edhe përfaqësues të: KFOR-it, OSBE-së, OJQ-ve, Mediat, Drejtorë të Drejtorive, qytetarët e interesuar etj

Në këtë komunë gjatë kësaj periudhe kanë funksionuar edhe Komitetet Obligative. Në tre mujorin e parë të vitit 2012, KPF dhe KK kanë mbajtur nga 3 mbledhje.

Në periudhën janar-mars të vitit 2012, në Komunën e Pejës është miratuar Raporti i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2011. Lidhur me këtë çështje ka raportuar Kryetari i Komunës z. Ali Berisha.

Kryetari i Komunës së Pejës, në këtë periudhë të raportimit ka emëruar për nënkryetar të Komunës për Komunitete z. Safet Zoraniq nga radhët e Komunitetit boshnjak, kjo pas vdekjes kohë më parë të nënkryetarit z. Ibish Bajrami.

Aktet më të rëndësishme

Në kuadër të aktivitetit të saj, Kuvendi i Komunës së Pejës gjatë tre-mujorit të parë të vitit 2012 ka miratuar gjithsej 17 vendime, ndërsa nuk ka miratuar asnjë rregullore. Ndër aktet komunale më të rëndësishme të cilat janë marrë gjatë kësaj periudhe janë:

1.Vendim për ndarjen e truallit në sipërfaqe prej 01.00,00 ha, nga ngastra.kad.nr.105/1 dhe 105/2 pronë e Komunës së Pejës, Z.K Zagërme, për varreza të fshatit Raushiq KK.Pejë.

2.Vendim për ndërrim të pozicionit të rrugës sipas fletëposedimit nr.171-0 pronë komunale me ngastra.kad.nr.104/1 dhe 104/2 pronë privatë në sipërfaqe relativisht të njëjtë.

Kuvendi i Komunës së Pejës gjatë kësaj periudhe ka miratuar edhe tri Plane Rregulluese Urbane:

- 1.Plani Rregullues Urban për:B.T."Kapeshnica-Puhovci",
- 2.Plani Rregullues Urban për:B.T."Puhovci-Jarina",
- 3.Plani Rregullues Urban për:B.T.Jarina-Xhemajl Kada".

Klinë

Komuna e Klinës në tre-mujorin e parë të vitit 2012 ka funksionuar normalisht. Kuvendi i Komunës gjatë kësaj periudhe ka mbajtur gjithsej 3 mbledhje të rregullta, ndërsa mbledhje të jashtëzakonshme nuk ka mbajtur. Në këtë periudhë kohore janë miratuar gjithsej 16 vendime dhe 1 rregullore.

Mbledhjet kanë qenë transparente dhe të hapura për publikun. Në mbledhje kanë qenë prezent edhe përfaqësues të: KFOR-it, OSBE-së, OJQ-ve, mediat, Drejtorë të Drejtorive, qytetarët e interesuar etj.

Komitetet Obligative kanë qenë funksionale për këtë periudhë. Në këtë drejtim, Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete kanë mbajtur nga 3 mbledhje.

Gjatë kësaj periudhe të raportimit, Kuvendi i Komunës së Klinës ka miratuar ndryshimin e rregullores për tarifën, ngarkesat dhe taksat komunale, rregullore kjo e cila është miratuar që në vitin 2008.

Në periudhën janar-mars të vitit 2012, në Komunën e Klinës është miratuar edhe Raporti i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2011, për të cilin raport ka raportuar Kryetari i Komunës.

Aktet më të rëndësishme

Në kuadër të aktivitetit të saj, Kuvendi i Komunës së Klinës ka miratuar gjithsej 16 vendime dhe 1 rregullore prej të cilave si më të rëndësishme mund të konsiderohen:

- 1.Vendim për ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores komunale për përcaktimin e ngarkesave, tarifave dhe taksave komunale, dhjetor 2008.
- 2.Vendim për iniciimin e procedurës për ndryshimin e Planit Zhvillimor Urban të vitit 2005-2015.
- 3.Vendim për miratimin e Raportit të punës së Ekzekutivit për vitin 2011.
- 4.Rregullore për Komitetet Konsultative.

Istog

Edhe Komuna e Istogut ashtu sikurse komunat paraprahe gjatë kësaj periudhe ka funksionuar normalisht. Ky Kuvend ka mbajtur gjithsej 3 mbledhje të rregullta, ndërsa mbledhje të jashtëzakonshme nuk ka mbajtur. Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit i pranishëm ka qenë edhe Kryetari i Komunës.

Monitorimi i mbledhjeve të Kuvendit është bërë përmes sistemit të teleprezencës.

Mbledhjet kanë qenë transparente dhe të hapura për publikun. Në mbledhje kanë qenë prezent edhe përfaqësues të: KFOR-it, OSBE-së, OJQ-ve, mediat, Drejtorë të Drejtorive, qytetarët e interesuar etj.

Kuvendi i Komunës së Istogut ka miratuar akte të ndryshme komunale. Prej tyre, gjithsej ka miratuar 9 vendime dhe 2 rregullore.

Komitetet obligative janë funksionale në Komunën e Istogut. Për këtë periudhe KPF dhe KK kanë mbajtur nga 3 mbledhje.

Komuna e Istogut nuk ka themeluar ndonjë Komitet tjetër në periudhën janar - mars të vitit 2012.

Komuna e Istogut ka miratuar raportin e punës së ekzekutivit për vitin 2011. Për këtë çështje ka raportuar Kryetari i Komunës së Istogut z.Haki Rugova.

Ajo që vlen të potencohet është se në muajin janar, për shkak të dëmeve të shkaktuara nga stuhia e erës kryetari i Komunës së Istogut ka shpallur gjendje të jashtëzakonshme. Lidhur me këtë çështje, kryetari i Komunës së Istogut z. Rugova, në mbledhjen e kuvendit të Komunës ka raportuar për dëmet e shkaktuara nga kjo stuhi.

Si rezultat i gjendjes së krijuar është themeluar Komisioni për monitorimin e punës së komisioneve të cilët kanë vlerësuar dëmet e erës së 6 dhe 7 janarit të vitit 2012.

Aktet më të rëndësishme

Prej gjithsej 9 vendimeve dhe 2 rregulloreve të miratuara, si më të rëndësishmet mund të konsiderohen:

- 1.Vendim për shfuqizimin e Rregullores për dhënien e lejes së punës subjekteve afariste në Komunën e Istogut.
- 2.Vendim për shfuqizimin e Rregullores mbi kompensimin e udhëtimeve zyrtare dhe mëditjeve.
- 3.Rregullore për transparencën komunale.
- 4.Rregullore për përdorimin e automjeteve zyrtare.

Suharekë

Kuvendi i Komunës së Suharekës në tre-mujorin e parë të vitit 2012 ka funksionuar normalisht. Ky Kuvend ka mbajtur gjithsej 3 mbledhje të rregullta, ndërsa mbledhje të jashtëzakonshme nuk ka mbajtur.

Në Komunën e Suharekës janë funksionale Komitetet obligative. Në periudhën janar - mars të vitit 2012, KPF ka mbajtur 3 mbledhje, kurse KK 2 mbledhje. Gjatë kësaj periudhe, nuk është themeluar ndonjë Komitet tjetër.

Në tre-mujorin e parë të vitit 2012 Kuvendi i Komunës së Suharekës ka miratuar edhe Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2012.

Po ashtu është miratuar edhe Raporti i punës së ekzekutivit për vitin 2011.

Në Komunën Suharekës është evidentuar një shkelje ligjore me rastin e marrjes së Vendimit mbi plotësimin e vendimit për këshillin e ekspertëve për hartimin e planit zhvillimor komunal, planin zhvillimor urban dhe planit rregullues urbane, vendim ky i cili është konstatuar se është në kundërshtim me nenin 3 të Ligjit për Barazi Gjinore Nr.2004/2.

Aktet më të rëndësishme

Prej gjithsej 13 vendimeve të miratuara në Kuvend, ndër më të rëndësishmet mund të përmendim:

- 1.Vendim mbi miratimin e planit rregullues në lagjen “Pojata” në Suharekë.
- 2.Vendim mbi miratimin e planit rregullues në lagjen “Shirok” në Suharekë.
- 3.Vendim mbi plotësim-ndryshim të këshillit të ekspertëve për PZHK,PZHU dhe PRRU.
- 4.Vendim për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat e tenderimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.
- 5.Vendim për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat e tenderimit për projektin me PPP-në.
- 6.Vendim për miratimin e raportit të menaxhimit financiar të buxhetit të Komunës në Suharekë.
- 7.Vendim për dhënien në shfrytëzim afat shkurt deri në 10 vite të pronës së paluajtshme të Komunës;

Të gjeturat

- Gjatë periudhës së raportimit, në Komunën e Malishevës është evidentuar një rast i lëshimit të mbledhjes së Kuvendit nga ana e anëtarëve të opozitës.
- Komuna e Malishevës, ende nuk e ka të miratuar Rregulloren për Përdorimin e Gjuhëve.
- Në Komunën e Malishevës ende nuk është bërë zëvendësimi i anëtarit të Kuvendit z. Bekim Samadraxha, i cili që një kohë të gjatë nuk merr pjesë në punimet e Kuvendit.
- Në Komunën e Malishevës, gjatë këtij tre-mujori janë themeluar edhe tre Komitete të tjera(Komiteti i Diasporës, Komiteti për Familje të Dëshmorëve, Invalid dhe Veteranë të Luftës së UÇK-së dhe Komiteti për Shëndetësi dhe Çështje Sociale).
- Kryetari i Komunës së Pejës ka emëruar për nënkryetar të Komunës për Komunitete z. Safet Zoraniq nga radhët e Komunitetit boshnjak. Ky emërim ka ardhur si rezultat që nënkryetari i Komunës për Komunitete z. Ibish Bajrami ka ndërruar jetë.
- Komuna e Pejës, për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme të krijuara nga kushtet atmosferike (të reshurat e borës) gjatë periudhës së raportimit ka shpallur gjendje të jashtëzakonshme.

- Komuna e Istogut ka shpallur gjendje të jashtëzakonshme gjatë periudhës së raportimit për shkak të dëmeve të shkaktuara nga stuhia e erës.
- Komuna e Istogut, gjatë këtij tre-mujori ka themeluar Komisionin për monitorimin e punës së komisioneve të cilët kanë vlerësuar dëmet e erës së 6 dhe 7 janarit të vitit 2012.
- Në Komunën Suharekës është evidentuar një shkelje ligjore me rastin e marrjes së Vendimit mbi plotësimin e vendimit për këshillin e ekspertëve për hartimin e planit zhvillimor komunal, planin zhvillimor urban dhe planit rregullues urbane, vendim ky i cili është konstatuar se është në kundërshtim me nenin 3 të Ligjit për Barazi Gjinore Nr.2004/2.
- Në Komunën e Suharekës është miratuar Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2012.

KOMUNAT: FERIZAJ, KAÇANIK, SHTIME, SHTËRPCË, MAMUSHË DHE GRAÇANICË

Mbledhjet e mbajtura

Gjatë 3 mujorit të parë të vitit 2012, Kuvendet e Komunave: **Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Shtërpcë, Mamushë** dhe **Graçanicë** kanë zhvilluar një ritëm të mirë sa i përket mbajtjes së mbledhjeve.

Në kuvendet e këtyre komunave gjatë kësaj periudhe janë mbajtur gjithsej 17 mbledhje.




Fig.12. Numri i mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave: Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Shtërpcë, Mamushë dhe Graçanicë

Nga figura e sipërme shihet se Kuvendet e Komunave: Ferizaj, Shtime, Shtërpcë Mamushë dhe Graçanicë, gjatë periudhës janar-mars 2011 kanë mbajtur nga 3 mbledhje, përderisa Kuvendi i Komunës së Kaçanikut ka mbajtur 2 mbledhje.

Komiteti për Politikë dhe Financa ka funksionuar normalisht në këto komuna. Në total janë mbajtur 17 mbledhje, më konkretisht, KPF në Komunën e Ferizajt, Shtimes, Shtërpcës, Mamushës dhe Graçanicës ka mbajtur nga 3 mbledhje, ndërsa në Komunën e Kaçanikut ka mbajtur 2 mbledhje.

Komiteti për Komunitete është i themeluar në këto komuna dhe gjatë kësaj periudhe ka funksionuar, me përjashtim të Komunës së Kaçanikut e cila nuk ka mbajtur asnjë mbledhje. Në komunat e lart përmendura numri i mbledhjeve të KK-së rezulton të jetë,

si në vijim: në Komunën e Ferizajt, Shtimes, Graçanicës dhe Mamushës, KK ka mbajtur nga 3 mbledhje, ndërsa në Komunën e Shtërpçës KK ka mbajtur 2 mbledhje.




Fig.13. Numri i mbledhjeve të Komiteteve të obligueshme: Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Shtërpçe, Mamushë dhe Graçanicë

Sa i përket dërgimit të ftesave dhe materialeve për mbledhje të Kuvendit, Komuna e Ferizajt, Kaçanikut, Shtimes, Shtërpçës, Mamushës dhe Graçanicës i dërgojnë me kohë, mirëpo duhet përmendur se Komuna e Graçanicës edhe pse dërgimin e ftesave dhe materialeve e bënë me kohë, atë e bënë në të dy gjuhët, mirëpo në gjuhën shqipe e dërgon me vonesë për shkak se ka të punësuar vetëm një përkthyes.

Lidhur me miratimin e akteve komunale, Komunitat: Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Shtërpçe, Mamushë dhe Graçanicë, gjithsej kanë miratuar 75 vendime dhe 8 rregullore, prej tyre Komuna e Ferizajt ka miratuar 9 vendime dhe asnjë rregullore, Komuna e Kaçanikut ka miratuar 9 vendime dhe asnjë rregullore, Komuna e Shtimes ka miratuar 26 vendime dhe 2 rregullore, Komuna e Shtërpçes ka miratuar 11 vendime dhe 3 rregullore, Komuna e Mamushës ka miratuar 4 vendime dhe 1 rregullore, si dhe Komuna e Graçanicës ka miratuar 16 vendime dhe 2 rregullore.




Fig.14. Numri i akteve komunale të miratuara në Kuvendet e Komunave: Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Shtërpce, Mamushë dhe Graçanicë

Sa i përket publikimit të akteve komunale dhe ftesave për mbajtjen e mbledhjeve në ueb faqe të Komunës, Komuna e Ferizajt, Shtimes dhe Kaçanikut i publikojnë vendimet dhe rregulloret në ueb- faqe, si dhe ftesat për mbajtjen e mbledhjeve, ndërsa Komuna e Graçanicës dhe Mamushës, gjatë këtij 3 mujori nuk kanë bërë publikimin e akteve komunale në ueb-faqet e tyre.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka funksionuar në Komunën e Ferizajt, Shtimes dhe Kaçanikut duke mbajtur nga 3 mbledhje, ndërsa në Komunën e Shtërpces, Mamushës dhe Graçanicës, ky Këshill nuk ka mbajtur asnjë mbledhje.




Fig.15. Numri i takimeve të KKSb-ve në komunat: Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Shtërpce, Mamushë dhe Graçanicë

Përmbledhje nga mbledhjet e kuvendeve

Ferizaj

Në periudhën janar-mars të vitit 2012, Kuvendi i Komunës së Ferizajt është mbledhur gjithsej 3 herë. Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar aktivitete të shumta, ku janë trajtuar çështje me interes për qytetarët e kësaj komune.

Në muajin mars, konkretisht me datën 21.03.2012, Kryetari i Komunës së Ferizajt me të marrë në dijeni se Gjykata Supreme e Kosovës ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, me të cilin kjo gjykatë e ka shpallur fajtor për veprën penale shkaktim i rrezikut në komunikacion dhe e ka dënuar me dy vjet e gjysmë heqje lirie, ende pa e pranuar aktgjykimin e Gjykatës supreme të Kosovës, si akt moral dhe në shenjë të respektimit të drejtësisë me datën 21.03.2012, ka dhënë dorëheqje nga pozita e Kryetarit të Komunës së Ferizajt. Kjo do të thotë se mandati i Kryetarit të Komunës së Ferizajt ka përfunduar konform dispozitave të nenit 56.3 pika c të LVL-së, nr. 03/L-040. Duke u bazuar në dispozitat e nenit 60 paragrafi 60.3 të LVL-së, dhe në dispozitat e nenit 6 të Udhëzimit administrativ Nr.03/2010 MAPL për procedurën e përfundimit të mandatit të Kryetarit të Komunës, pozitën e Kryetarit të Komunës deri në zgjedhjen e Kryetarit të Komunës do ta ushtroj nënkryetari i Komunës z. Besim Zymberi.

Vlen të theksohet se zgjedhjet për Kryetar të Komunës së Ferizajt janë shpallur nga Presidentja e Kosovës me datën 29 prill 2012.

Pasi që në këtë komunë do të ketë zgjedhje për pozitën e Kryetarit të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës ka shpalluar kandidaturën e tij për Kryetar të

Komunës dhe për ti ikur konfliktit të interesit ka pezulluar funksionin e Kryesuesit të Kuvendit.

Po ashtu, edhe drejtori për kulturë, rini dhe sport z. Naim Ferati ka dhënë dorëheqje nga pozita e drejtorit, pasi që do të jetë njëri nga kandidatët për Kryetar të Komunës së Ferizajt në zgjedhjet e 29 prillit.

Komuna e Ferizajt gjatë muajit janar ka shpallur gjendje gatishmërie për shkak të kushteve atmosferike dhe borës së madhe që mbretëruar në këtë Komunë.

Aktet më të rëndësishme

Sa i përket miratimit të akteve komunale, gjatë periudhës janar-mars të vitit 2012, Kuvendi i Komunës së Ferizajt ka miratuar gjithsej 9 vendime.

Komuna e Ferizajt rëndësi të veçantë i ka kushtuar planeve rregulluese, ku për këtë çështje ka miratuar 3 vendime vetëm për hartimin e këtyre planeve.

Po ashtu, Kuvendi i Komunës së Ferizajt ka diskutuar edhe raportin e vjetor për vitin 2011 të Kryetarit të Komunës.

Shtime

Gjatë periudhës janar-mars të vitit 2012, Kuvendi i Komunës së Shtimes ka mbajtur gjithsej 3 mbledhje. Kryetari i Komunës në shumicën e mbledhjeve është prezent, kurse drejtorët e drejtorive në shumicën e mbledhjeve nuk janë prezent.

Në muajin janar dhe shkurt të vitit 2012, Komuna e Shtimes nuk ka shpallur gjendje emergjente me rastin e reshjeve të mëdha të borës.

Aktet më të rëndësishme

Lidhur me miratimin e akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Shtimes gjatë kësaj periudhe raportuese ka miratuar gjithsej 26 vendime dhe 2 rregullore. Në këtë periudhë, ky Kuvend ka miratuar një vargë kërkesash të qytetarëve të cilat në të shumtën e rasteve janë refuzuar për shkak të mos adresimit të saktë të tyre apo janë kthyer në drejtoritë përkatëse. Një pjesë e këtyre kërkesave janë refuzuar për shkak të mundësive të limituara buxhetore.

Kuvendi i Komunës së Shtimes ka miratuar raportin financiar të qeverisë komunale për vitin 2011, vendimin për riemërimin e çerdhes së fëmijëve, rregulloren për ndarjen e bursave për student si dhe planin e punës së kuvendit për vitin 2012.

Po ashtu, Kuvendi i Komunës së Shtimes ka miratuar rregulloren për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane.

Kaçanik

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut gjatë periudhës janar-mars të vitit 2012 ka mbajtur gjithsej 2 mbledhje.

Pas dorëheqjes së anëtarit të kuvendit z. Shukri Luta nga subjekti politik i AAK-së dhe kalimit të tij në kuvend si anëtar i pavarur, në Komitetin për Politikë dhe Financa është bërë zëvendësimi i tij me anëtarin e subjektit të AAK-së z. Rami Çaka.

Në periudhën e muajit janar dhe shkurt të vitit 2012, Komuna e Kaçanikut nuk ka shpallur gjendje emergjente me rastin e reshjeve të mëdha të borës.

Aktet më të rëndësishme

Sa i përket miratimit të akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut ka miratuar 9 vendime, ndërsa nuk ka miratuar ndonjë rregullore.

Ndër vendimet më të rëndësishmet që ka miratuar ky Kuvend janë:

- 1.Vendim për hartimin e planeve rregulluese në zonat turistike në Komunën e Kaçanikut.

- 2.Vendim për lirimin e bizneseve nga taksat komunale-ngarkesat vjetore për ushtrimin e veprimtarisë së tyre etj.

Po ashtu, edhe Komuna e Kaçanikut ka miratuar rregulloren për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane.

Kuvendi i Komunës ka miratuar raportin e punës së qeverisë komunale për vitin 2011.

Shtërpcë

Gjatë tre mujorit të parë të vitit 2012, Kuvendi i Komunës së Shtërpcës ka realizuar 3 mbledhje.

Kuvendi i Komunës së Shtërpcës ka miratuar raportin e punës së ekzekutivit për vitin 2011. Në mbledhjet e Kuvendit, mungon pjesëmarrja e kryetarit të Komunës në shumicën prej tyre, ndërsa drejtorët e drejtorive marrin pjesë në mbledhjet e kuvendit.

Në muajin janar dhe shkurt të vitit 2012 me rastin e reshjeve të mëdha të borës, Komuna e Shtërpcës nuk ka shpallur gjendje emergjente.

Aktet më të rëndësishme

Kuvendi i Komunës së Shtërpcës ka miratuar akte të ndryshme komunale, prej tyre 11 vendime dhe 3 rregullore.

Aktet më të rëndësishme komunale të cilat janë marrë gjatë kësaj periudhe janë:

- 1.Vendim për themelimin e spitalit të Shtërpcës.
- 2.Vendim për themelimin e komisionit për hartimin e statutit të spitalit nga Kuvendi.
- 3.Vendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Qendrës për Punë Sociale.

MAPL pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë ka konstatuar se Komuna e Shtërpçës ka të drejtë me vendim të përcaktoj hapësirën për ndërtimin e objektit të Qendrës për Punë Sociale në Shtërpçe, mirëpo nëse prona ku duhet të ndërtohet objekti nuk është prone komunale, por është pronë e ndërmarrjeve shoqërore, e cila menaxhohet nga AKP, atëherë Komuna e Shtërpçës duhet ti ndërmarr veprimet tjera të përcaktuara me ligj, me qëllim të transferimit të kësaj prone në pronë komunale, konform ligjit në fuqi për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës.

Po ashtu, janë miratuar tri rregullore të cilat kanë kaluar diskutimet publike me qytetar dhe pas inkorporimit të vërejtjeve janë kthyer në Kuvend ku kanë marrë miratimin përfundimtarë.

Mamushë

Kuvendi i Komunës së Mamushës, gjatë periudhës janar-mars të vitit 2012 është mbledhur gjithsej 3 herë. Në fillim ka pasur vështirësi për funksionalizimin e sistemit të teleprezencës, mirëpo tani është funksionale. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Mamushës zhvillohen në gjuhën turke dhe me këtë rast gjatë monitorimit të mbledhjeve janë shfaqur probleme në çështjen e përkthimit simultan, ngase Komuna e Mamushës ballafaqohet me mungesën e përkthyesit zyrtar nga gjuha turke në atë shqipe dhe anasjelltas.

Komuna e Mamushës nuk ka shpallur gjendje emergjente gjatë muajit janar dhe shkurt me rastin e reshjeve të mëdha të borës.

Pas shkresës së dërguar nga MAPL-ja në adresë të Komunës së Mamushës për themelimin dhe funksionalizimin e KKBS, ky Këshill është formuar në këtë komunë gjatë muajit mars, por nuk ka arrit të mbaj asnjë mbledhje.

Në mbledhjen e fundit të Kuvendit të Komunës së Mamushës, Kryetari i Komunës e ka informuar Kuvendin lidhur me funksionimin, detyrat dhe përgjegjësit e KKSB-së.

Aktet më të rëndësishme

Kuvendi i Komunës së Mamushës ka miratuar akte të ndryshme komunale. Gjatë periudhës jana - mars të vitit 2012, Kuvendi ka miratuar 4 vendime dhe 1 rregullore. Aktet më të rëndësishme komunale të cilat janë marrë gjatë kësaj periudhe janë:

- 1.Vendim për emblemen e Komunës së Mamushës.
- 2.Miratimi i raportit të punës së kryetarit për vitin 2011.
- 3.Rregullore për orarin e punës së subjekteve afariste në territorin e Komunës së Mamushës.

Graçanicë

Kuvendi i Komunës së Graçanicës, gjatë periudhës janar-mars të vitit 2012 është mbledhur gjithsej 3 herë. Në këtë periudhë janë zhvilluar aktivitete të shumta, ku janë trajtuar çështje me interes për qytetarët e kësaj komune.

Në periudhën janar - mars të vitit 2012 është evidentuar një rast i deklarimit të konfliktit të interesit nga ana e Kryesuesit të Kuvendit. Rasti ka të bëjë me shqyrtimin e një kërkesës, ku direkt është prekur edhe interesi i tij. Me këtë rast, Kryesuesi i Kuvendit ka hequr dorë nga procesi i votimit në miratimin e kësaj pike me qëllim që mos të shkaktoj konflikt të interesit.

Sistemi i teleprezencës në Komunën e Graçanicës ende nuk është funksionalizuar plotësisht, për shkak se MAP-i është duke funksionalizuar domenin qeveritar në këtë komunë. Deri më tani, Komuna e Graçanicës nuk ka qenë e lidhur me rrjetin e qeverisë.

Komuna e Graçanicës nuk ka shpallur gjendje emergjente gjatë muajit janar dhe shkurt të vitit 2012 me rastin e reshjeve të mëdha të borës.

Në Komunën e Graçanicës ende nuk është funksionalizuar Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi.

Aktet më të rëndësishme

Gjatë kësaj periudhe kuvendi ka miratuar 9 vendime dhe 2 rregullore.

Aktet më të rëndësishme komunale të cilat janë marrë gjatë kësaj periudhe janë:

- 1.Vendim për miratimin e planit rregullues urban për lagjen vikend në Çagllavicë.
- 2.Vendim për ditët e hapura për qytetar. Me këtë vendim, Kuvendi ka caktuar se e mërkura e 3-të e çdo muaji të jetë dita kur qytetarët do të jenë në gjendje të takohen me anëtarët e kuvendit dhe të diskutojnë me ta në parashtrimin e kërkesave të tyre.
- 3.Rregullore për transparencën komunale.

Të gjeturat

- Në Kuvendin e Komunës së Ferizajt, anëtarët e kuvendit parashtrojnë shumë pyetje në adresë të ekzekutivit të komunës, mirëpo ekzekutivi i komunës në të shumtën e rasteve nuk i përgjigjet pyetjeve të kuvendarëve, e që me këtë rast po shkaktohen ankesa të shumta nga anëtarët e kuvendit.
- Në Kuvendin e Komunës së Shtimes, krijohet jorend me rastin e marrjes së fjalës.
- Në Kuvendin e Komunës së Shtimes, është shtuar tendenca e Kryesuesit të Kuvendit në ndikimin e qëndrimit të tij ndaj anëtarëve të kuvendit.
- Në Komunën e Kaçanikut, Komiteti për Komunitete është i themeluar, mirëpo gjatë kësaj periudhe ky komitet nuk ka qenë funksional dhe nuk ka mbajtur asnjë mbledhje.
- Komuna e Shtërpçës e ka të themeluar KKSB-në, mirëpo nuk ka arritë të funksionalizoj këtë Këshill, si dhe nuk ka mbajtur asnjë mbledhje.
- Kuvendi i Komunës së Shtërpçës ka miratuar ndarjen e lokacionit për ndërtimin e objektit ku përfshihet ngastra kadastrare nr.2211 zona kadastrale Shtërpçë fleta poseduese nr. 467, në sipërfaqe prej 3 ari vendi i quajtur ‘Taraia’, me kulturë kullësë kl. 4, pronë shoqërore, në emër të “ Të panjohur’ Shtërpçë”. Për këtë vendim MAPL, përmes një shkrese ka kërkuar nga Komuna e Shtërpçës që të ndërmerren veprimet e duhura konform ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës. Nga komuna pritet të ndërmerren veprime konkrete konform shkresës së dërguar nga MAPL.
- Në Komunën e Mamushës, gjatë kësaj periudhe ka pasur vështirësi në përkthimin e mbledhjeve të Kuvendit.
- Komuna e Mamushës ka themeluar Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, mirëpo ende nuk ka arritur të funksionalizoj këtë Këshill dhe të mbajë ndonjë mbledhje gjatë kësaj periudhe.
- Në Komunën e Graçanicës ende nuk është funksionalizuar Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi.

KOMUNAT: PRISHTINË, PODUJEVË, LIPJAN DHE FUSHË-KOSOVË

Mbledhjet e mbajtura

Në periudhën janar – mars të vitit 2012, Kuvendet e Komunave: **Prishtinë, Podujevë, Lipjan dhe Fushë Kosovë** kanë mbajtur gjithsej 13 mbledhje. Prej tyre, Kuvendi i Komunës së Prishtinës ka mbajtur 4 mbledhje të rregullta dhe asnjë të jashtëzakonshme, ndërsa Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, Lipjanit dhe Podujevës kanë mbajtur nga 3 mbledhje të rregullta.




Fig.16. Numri i mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave: Prishtinë, Podujevë, Lipjan dhe Fushë Kosovë

Ashtu siç parashihet me LVL-në, këto Komuna janë brenda dinamikës së paraparë sa i përket mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit.

Ftesat dhe materialet për mbledhje nga këto Komuna, janë dërguar me kohë dhe në përputhje me nenin 43 të LVL-së.

Komitetet obligative dhe komitetet e tjera kanë qenë funksionale për periudhën janar – mars 2012. Në Kuvendin e Komunës së Prishtinës, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 4 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete 3 mbledhje, në Kuvendin e Komunës së Podujevës dhe Lipjanit, KPF ka mbajtur nga 3 mbledhje, kurse KK 2 mbledhje, si dhe në Kuvendin e Komunës së Fushë Kosovës, KPF dhe KK kanë mbajtur nga 3 mbledhje.




Fig.17. Numri i mbledhjeve të Komiteteve të obligueshme: Prishtinë, Podujevë, Lipjan dhe Fushë Kosovë

Gjatë kësaj periudhe, nuk ka pasur raste që ndonjë subjekt politik të mos merr pjesë në punën e kuvendit.

Rrjedha e punës së Kuvendeve të këtyre Komunave është shoqëruar me diskutime konstruktive, si nga opozita por edhe nga pozita, për pikat e rendit të ditës të cilat kanë qenë më me prioritet për qytetarin. Rregullorja e Punës së Kuvendit është respektuar nga Komunitat.

Mbledhjet e mbajtura kanë qenë transparente për publikun. Zakonisht në takime është vërejtur prezenca e OSBE-së të cilët monitorojnë punën e Kuvendeve të Komunave, OJQ-ve të ndryshme, mjeteve të informimit si dhe e qytetarëve të interesuar.

Informimi i qytetarëve për mbledhje apo ndonjë aktivitet të Komunës bëhet përmes shpalljeve publike dhe ueb faqes së Komunës.

Kuorumi në të gjitha këto mbledhje ka qenë i mjaftueshëm, ndërsa sa i përket votimit të gjitha vendimet merren me shumicë të votave.

Këto komuna kanë miratuar disa vendime me interes për Komunën dhe qytetarët.




Fig. 18. Numri i akteve të miratuara në Kuvendet e Komunave: Prishtinë, Podujevë, Lipjan dhe Fushë Kosovë.

Nga figura e mësipërme shihet se Kuvendi i Komunës së Prishtinës ka miratuar 13 vendime, Komuna e Podujevës ka miratuar 10 vendime dhe asnjë rregullore, ndërsa Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës dhe Lipjanit kanë miratuar nga 5 vendime.

KKSB është trup konsultues për çështje të sigurisë me përfaqësim të gjerë të të gjitha bashkësive në një komunë. Ky Këshill mban jo më pak se 10 takime në vit. Në Komunën e Prishtinës, Podujevës dhe Lipjanit, KKSB ka qenë funksionale dhe ka mbajtur 2 mbledhje, ndërsa në Komunën e Fushë Kosovës, ky Këshill nuk ka mbajtur asnjë mbledhje.




Fig.19. Numri i takimeve të KKSB-ve në komunat: Prishtinë, Podujevë, Lipjan dhe Fushë Kosovë

Prishtinë

Kuvendi i Komunës së Prishtinës funksionon në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Statutit të Komunës dhe Rregullores së punës së Kuvendit.

Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi i kësaj Komune, ka mbajtur 4 mbledhje të rregullta dhe asnjë të jashtëzakonshme.

Këto mbledhje kanë qenë transparente për publikun, në to kanë marrë pjesë ekzekutivi i komunës, nënkryetari i komunës dhe drejtorët e drejtorive, monitoruesit nga OSBE, si dhe mediat e shumta të cilat përcjellin mbledhjet e Kuvendit.

Komuna e Prishtinës ka funksionalizuar teleprezencën e vendosur nga MAPL-ja, ku të gjitha mbledhjet e Kuvendit monitorohen përmes saj.

Lidhur me Komitetet Obligative, si trupa të kuvendit kanë funksionuar edhe gjatë kësaj periudhe. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 4 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete 3 mbledhje.

Në Komunën e Prishtinës ende nuk janë themeluar Komitetet Konsultative, obligim ligjor i dalë nga LVL-ja.

Një nga detyrat dhe përgjegjësit e Kryetarit të Komunës është edhe raportimi i tij para Kuvendit. Kryetari i Komunës së Prishtinës ka raportuar para anëtarëve të kuvendit për vitin 2011, duke paraqitur të arriturat dhe vështirësit që ka hasur Komuna e Prishtinës në realizimin e projekteve të ndryshme.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe Kuvendi i Komunës së Prishtinës është përcjellur edhe me raportimin e Komisionit të Aksionarëve Komunal në Ndërmarrjet Publike, obligim i dal nga Ligji për Ndërmarrjet Publike.

Sipas nenit 8.2, Komisioni Komunal i Aksionarëve do t'i raportojë Kuvendit të Komunës në baza vjetore mbi performancën e këtyre kompanive, kompetencave dhe përgjegjësi, si dhe mbi arritjen e objektivave të përcaktuara në politikën e pronësisë së përcaktuar.

Komuna e Prishtinës e ka të miratuar rregulloren për Organizimin dhe Bashkëpunimin me Fshatra, Vendbanime dhe Lagje Urbane.

Komuna e Prishtinës nuk ka shpallur gjendje të jashtëzakonshme edhe për kundër kushteve të vështira atmosferike që ka kaluar në periudhën janar – mars të vitit 2012.

Sa i përket vlerësimit të ligjshmërisë së akteve të miratuara dhe dërgimit të tyre në MAPL, Komuna e Prishtinës është treguar e përgjegjshme në këtë periudhë, pasi që të gjitha aktet e miratuara i ka dërguar brenda afatit ligjor në organin mbikëqyrës.

Aktet më të rëndësishme

Kuvendi i Komunës së Prishtinës gjatë kësaj periudhe ka miratuar 13 vendime, ndërsa sa i përket rregulloreve, është plotësuar dhe ndryshuar Rregullorja për Kushtet dhe Kriteret për Ushtrimin e Veprimtarisë së Transportit Taksi të Udhëtarëve.

Një ndër vendimet më të rëndësishme të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës është:

1. Plotësimi i Vendimit për Emërtimin dhe Zyrtarizimin e Lagjeve, Shesheve dhe Rrugëve të Komunës së Prishtinës.

2. Vendim për ndryshimin e Rregullores për Transparencë. Ky ndryshim është bërë në nenin 5 të kësaj rregullore, ku thuhet se vendimin për mbylljen e Komitetit për Politikë dhe Financa e merr Kryesuesi i Kuvendit.

Me qëllim të rritjes së transparencës në mbledhjet e këtij komiteti, MAPL-ja, duke u mbështetur në nenin 82, paragrafi 2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, ka rekomanduar Kuvendin e Komunës së Prishtinës që në njërin nga mbledhjet e saj, të miratojë ndryshimin e nenit 5, duke e harmonizuar atë me nenin 45 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenin 3 të U. A. për transparencë në komuna nr. 2008/9.

Kuvendi i Komunës së Prishtinës ka marr për bazë rekomandimet e dala nga MAPL, dhe ka ndryshuar dhe plotësuar këtë rregullore me qëllim të rritjes së transparencës në këtë Komitet.

Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi ka plotësuar dhe ndryshuar Statutet e Qendrave të Mjekësisë Familjare, pas rekomandimeve të dala nga Komisioni Qeveritar për Mbikëqyrje të ligjshmërisë.

Podujevë

Kuvendi i Komunës së Podujevës gjatë tre mujorit të parët të vitit 2012 ka qenë funksional dhe ka mbajtur 3 mbledhje të rregullta dhe asnjë të jashtëzakonshme.

Rrjedha e punës së këtyre mbledhje është shoqëruar me debate konstruktive. Po ashtu, Kuvendi i Komunës së Podujevës ka respektuar Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Këto mbledhje kanë qenë transparente për publikun. Ftesat dhe materialet iu dërgohen me kohë anëtarëve të kuvendit dhe MAPL-së njëkohësisht. Njoftimi për mbledhje bëhet përmes shpalljeve publike, mjeteve të informimit, ueb- faqes së komunës.

Këto mbledhje janë monitoruar përmes sistemit të teleprezencës, e cila është funksionale në këtë komunë.

Sa i përket funksionimit të Komiteteve Obligative, këto Komitete kanë qenë funksionale dhe kanë mbajtur këtë numër të mbledhjeve: Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 3 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete 2 mbledhje.

Edhe gjatë kësaj periudhe, Komuna e Podujevës nuk ka themeluar Komitet Konsultative ashtu siç parashihet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Kryetari i Komunës, nuk ka raportuar para anëtarëve të kuvendit për periudhën janar – dhjetor të vitit 2011, ashtu siç obligohet me nenin 58 të LVL-së.

Aktet më të rëndësishme

Kuvendi i Komunës së Podujevës, gjatë kësaj periudhe ka miratuar 10 vendime dhe asnjë rregullore.

Ndër aktet komunale më të rëndësishme të cilat janë marrë gjatë kësaj periudhe janë:

1. Ndryshimi dhe Plotësimi i Statutit të Komunës së Podujevës. Ky ndryshim ka të bëjë me rritjen e numrit të drejtorive, ku Drejtoria për Buxhet, Financa, Planifikim dhe Zhvillim, ndahet në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave dhe Drejtorinë për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik.

Po ashtu edhe emërtimi i Zyrës Komunale për Kthim ndryshohet në Zyrën Komunale për Kthim dhe Komunitete.

Komuna e Podujevës ende nuk e ka miratuar Rregulloren për Organizimin dhe Bashkëpunimin me Fshatra, Vendbanime dhe Lagje Urbane

Sa i përket vlerësimit të ligjshmërisë së akteve komunale dhe dërgimit të tyre në adresë të MAPL-së, Komuna e Podujevës është mjaft e përgjegjshme në dërgimin e akteve komunale, duke respektuar afatin ligjor.

Lipjan

Kuvendi i Komunës së Lipjanit funksionin në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës dhe Rregullores së Punës.

Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi i Komunës së Lipjanit ka qenë funksional dhe ka mbajtur 3 mbledhje të rregullta dhe asnjë të jashtëzakonshme.

Sistemi i teleprezencës në Komunën e Lipjanit është funksionale dhe monitorimi i mbledhjeve të Kuvendit bëhet përmes këtij sistemi. Këtë sistem e ka instaluar MAPL-ja.

Këto mbledhje kanë qenë transparente për publikun, ftesat dhe mbledhjet dërgohen me kohë, ndërsa njoftimi për mbledhje bëhet përmes tabelës së shpalljes, mjeteve të informimit dhe ueb- faqes së komunës.

Sa i përket prezencës së ekzekutivit të komunës në mbledhjet e kuvendit, në këtë Kuvend vazhdon të përcjell praktika e mospranisë së tyre në mbledhje. Këtë vërejtje e kanë bërë edhe nga anëtarët e kuvendit.

Komitetet obligative si trupa të kuvendit kanë funksionuar gjatë kësaj periudhe. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 3 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur 2 mbledhje.

Gjatë kësaj periudhe, Kryetari i Komunës ka raportuar para anëtarëve të kuvendit duke respektuar obligimet ligjore.

Aktet më të rëndësishme

Kuvendi i Komunës së Lipjanit gjatë kësaj periudhe ka miratuar 5 vendime

Ndër aktet komunale më të rëndësishme të cilat janë marrë gjatë kësaj periudhe janë:

- 1.Vendim për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2011 në vitin 2012.
- 2.Vendim për ndërrimin e ngastrave kadastrale në mes të Komunës dhe P.SH. Miniera e Magnezitit Golesh- AKP-së. Ky vendim parasheh ndërrimin e ngastrave kadastrale në mes të Komunës dhe AKP-së, për vendosjen e pompave të ujit, me qëllim të furnizimit të rregullt të qytetarëve me ujë.

Po ashtu gjatë kësaj periudhe, janë paraqitur edhe raportet e punës së komiteteve obligative dhe komiteteve të tjera, duke e cilësuar si mjaft efikase punën e këtyre komiteteve.

Komuna e Lipjanit e ka miratuar Rregulloren për Organizimin dhe Bashkëpunimin me Fshatra, Vendbanime dhe Lagje Urbane.

Sa i përket vlerësimit të ligjshmërisë së akteve dhe dërgimit të tyre në adresë të MAPL-së, Komuna e Lipjanit nuk është e përgjegjshme në dërgimin e akteve komunale për vlerësim të ligjshmërisë.

Fushë-Kosovë

Edhe gjatë kësaj periudhe, Kuvendi i Komunës së Fushë- Kosovës ka funksionuar normalisht dhe ka mbajtur 3 mbledhje të rregullta dhe asnjë të jashtëzakonshme.

Këto mbledhje kanë qenë transparente për publikun. Në këto mbledhje ç`do herë është vërejtur prezenca e ekzekutivit të komunës, duke përfshirë edhe Kryetarin e Komunës, i cili çdo herë është i gatshëm të përgjigjet në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

N mbledhjet e kuvendit, debatet kanë qenë konstruktive. Në këtë periudhë, vendimet janë marrë në mënyrë unanime, pasi në këtë Kuvend ekziston konsensusi politik ndërmjet grupeve parlamentare.

Sa i përket funksionalizimit të teleprezencës të vendosur nga MAPL-ja, Komuna e Fushë Kosovës ende has në vështirësi në përdorimin e saj, si pasojë e jo profesionalizimit të zyrtarit të IT-së.

Komitet obligative si trupa të kuvendit, kanë qenë funksionale gjatë kësaj periudhe. KPF dhe KK kanë mbajtur nga 3 mbledhje.

Obligim ligjor i dalë nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale është edhe themelimi i Komiteteve Konsultative. Komuna e Fushë Kosovës ende nuk e ka themeluar këtë Komitet.

Një nga detyrat dhe përgjegjësit e Kryetarit të Komunës është edhe raportimi para anëtarëve të kuvendit. Kryetari i Komunës së Fushë-Kosovë ka raportuar para anëtarëve të kuvendit, duke paraqitur të arriturat dhe sfidat e kësaj komune.

Komuna e Fushë-Kosovës, nuk ka shpallur gjendje të jashtëzakonshme në territorin e saj, për shkak të kushteve të vështira atmosferike që ka mbretëruar në muajt e kaluar.

Aktet më të rëndësishme

Kuvendi i Komunës së Fushë Kosovës ka miratuar akte të ndryshme komunale. Në këtë drejtim, ky Kuvend ka miratuar 5 vendime.

Ndër aktet komunale më të rëndësishme të cilat janë marrë gjatë kësaj periudhe janë:

1.Vendim për miratimin e Planit Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave 2012-2015. Me këtë plan parashihet: eliminimi i depove të egra, riciklimi i mbeturinave, krijimi i një eko depoje, si dhe krijimin e një kompanie komunale për grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave në të ardhmen.

2.Vendim për miratimin e Panit të Veprimit Lokal për Mirëmbajtjen e Sipërfaqeve të Gjelbëruara 2012-2013. Ky plan parashihet rregullimin dhe përmirësimin e shërbimeve për mbrojtjen e mjedisit.

Kuvendi i Komunës së Fushë Kosovës që nga viti 2008 e ka të miratuar Rregulloren për Organizimin dhe Bashkëpunimin me Fshatra, Vendbanime dhe Lagje Urbane.

Komuna e Fushë Kosovës është mjaft e përgjegjshme në dërgimin e akteve komunale në organin mbikëqyrës për vlerësim të ligjshmërisë.

Të gjeturat

- Në Komunën e Podujevës është evidentuar një shkelje ligjore me rastin e miratimit të Vendimit për Riemërimin e Paluajtshmërive në Pronësi të Komunës. Ky vendim është në kundërshtim me Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 03/L-226. MAPL, përmes një shkrese ka kërkuar që Komuna ta kthej në rishqyrtim këtë vendim, por deri më tani ky rekomandim nuk është përmbushur nga ana e Komunës.
- Në Komunën e Podujevës, Kryetari i Komunës ka raportuar vetëm një herë para anëtarëve të kuvendit, duke mos respektuar dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, ku kryetari raporton para Kuvendit të Komunës së paku dy herë në vit.
- Komuna e Podujevës dhe Lipjanit kanë marrë vendim për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme në Komunë për shkak të kushteve të vështira atmosferike.
- Në Komunën e Lipjanit vazhdojnë të jenë funksionale 13 drejtori edhe pse me Statut të Komunës, ky numër nuk është i paraparë.
- Në Komunën e Lipjanit, emërimi i dy nënkryetarëve të komunës nga komuniteti shumicë vazhdon të jetë shkelje e dispozitave ligjore.
- Komuna e Fushë Kosovës ka probleme në funksionalizimin e sistemit të teleprezencës.

KOMUNAT: VITI, OBILIQ, HANI I ELEZIT, KLLOKOT, PARTESH DHE DRAGASH

Mbledhjet e mbajtura

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2012, Kuvendet e Komunave: **Viti, Obiliq, Hani i Elezit, Kllokot, Partesh dhe Dragash** kanë mbajtur mbledhje të rregullta, kurse disa nga komunat edhe mbledhje të jashtëzakonshme.

Raporti është hartuar mbi bazën e monitorimit të mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave, analizimit të dokumenteve të ndryshme si: procesverbaleve dhe rendit të ditës, bashkëpunimit me kryesuesit e kuvendeve, drejtorët e administratës si pika kontaktuese me MAPL-në, si dhe zyrtarëve të kuvendeve të komunave.

Gjatë periudhës janar - mars të vitit 2012, Kuvendet e këtyre komunave kanë mbajtur gjithësejt 16 mbledhje, prej tyre 13 mbledhje të rregullta dhe 3 të jashtëzakonshme.




Fig.20. Numri i mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave: Viti, Obiliq, Hani i Elezit, Kllokot, Partesh dhe Dragash

Komitetet Obligative, në këtë drejtim KPF dhe KK kanë qenë funksionale në Komunat: Viti, Obiliq, Hani i Elezit, Kllokot, Partesh dhe Dragash.




Fig.21. Numri i mbledhjeve të Komiteteve të obligueshme: Viti, Obiliq, Hani i Elezit, Kllokot, Partesh dhe Dragash

Mbledhjet kanë qenë transparente, ndërkohë që ftesat e mbledhjeve janë dërguar në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Gjatë kësaj periudhe, Kuvendet e këtyre komunave, kanë miratuar një numër aktesh, si rregullore dhe vendime. Kuvendi i Komunës së Vitisë ka miratuar 8 vendime, Kuvendi i Komunës së Obiliqit ka miratuar 13 vendime, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit ka miratuar 19 vendime dhe 1 rregullore, Kuvendi i Komunës së Kllokotit ka miratuar 6 vendime dhe 1 rregullore, Kuvendi i Komunës së Parteshit ka miratuar 6 vendime dhe 3 rregullore, si dhe Kuvendi i Komunës së Dragashit ka miratuar 7 vendime dhe 2 rregullore.




Fig.22. Numri i akteve të miratuara në Kuvendet e Komunave: Viti, Obiliq, Hani i Elezit, Klllokot, Partesh dhe Dragash

Kryetarët e Komunave marrin pjesë në mbledhjet e Kuvendit, përveç Komunës së Parteshit ku Kryetari i kësaj Komune asnjë herë nuk ka marrë pjesë në mbledhjet e Kuvendit.

Kurse, sa i përket sistemit të teleprezencës, këto komuna e kanë funksionalizuar këtë sistem. Procesi i monitorimit të mbledhjeve të Kuvendit zhvillohet përmes këtij sistemi.

Duhet të theksuar se në Kuvendet e këtyre komunave ka pasur debate të ndryshme të cilat kanë zgjuar interesim të madh të anëtarëve të kuvendit. Në disa komuna si p.sh në Obiliq dhe në Partesh, opozita e ka lëshuar mbledhjen si rezultat i pakënaqësis së treguar ndaj punës së Kuvendit.

Ndërsa, sa i përket mungesës së kuorumit, në këto Kuvende nuk ka pasur ndërprerje të punës. Mosmarrëveshjet kanë qenë prezente në shumë raste dhe për shumë çështje.

Gjithashtu, duhet të theksuar se edhe raportet e punës së këtyre kuvendeve janë miratuar.

Sa i përket funksionimit të KKSBB-ve, duhet thënë se realisht ka vështirësi në funksionimin e tyre, për shkak të moskompensimit të tyre.

Lidhur me numrin e mbajtjes së mbledhjeve të KKSBB-së, në Komunën e Vitisë, Obiliqit, Parteshit, Hanit të Elezit dhe Dragashit, ky Këshill i ka mbajtur nga 2 mbledhje, kurse në Komunën e Klllokotit i ka mbajtur 3 mbledhje.




Fig.23. Numri i takimeve të KKSBB-ve në komunat: Viti, Obiliq, Hani i Elezit, Klllokot, Partesh dhe Dragash

Viti

Kuvendi i Komunës së Vitisë gjatë periudhës së tre mujorit parë të vitit 2012 ka mbajtur 2 mbledhje të rregullta, ndërsa nuk ka mbajtur asnjë mbledhje të jashtëzakonshme.

Kuvendi ka funksionuar normalisht, ku çdo pikë e rendit të ditës ka zgjuar interesim për diskutim nga anëtarët e kuvendit duke reflektuar pozitivitetet dhe pjesëmarrje më të madhe në debate. Mbledhjet e mbajtura në këtë periudhë, çdo herë kanë filluar me debate të ashpra në mes të anëtarit të kuvendit z. Xhevat Bislimit dhe Kryetarit të Komunës z. Nexhmedin Arifit duke e përsëritur retorikën e akuzave personale ndërmjet tyre.

Mbledhjet kanë qenë transparente, ndërkohë që ftesat e mbledhjeve dhe materialet përcjellëse të rendit të ditës nuk janë dërguar me kohë, duke pasur një mospërfillje totale nga zyra për informim e Komunës. Arsyetimet e tyre janë se nuk mund të merren me punët e Ministrisë konkretisht të MAPL-së. Ndër të tjera, ata theksojnë se nuk e kanë obligim ligjor dërgimin e materialeve dhe se humbim shumë kohë në dërgimin e tyre. Këta zyrtar duke mos e ditur rëndësinë e punës së tyre të cilën e bëjnë janë shumë indiferent ndaj MAPL-së. Shumë Komuna përdorin postën elektronike si

mënyrë më e shpejtë dhe më efikase në dërgimin e materialeve duke larguar dërgimin e tyre në mënyrë fizike. I sugjerojmë këtyre zyrtarëve që të përdorin metodat bashkëkohore të punës me qëllim që ta përmbushin obligimin ligjor.

Kuvendi i Komunës së Vitisë e ka obligim ligjor të dërgojë materialin e mbledhjeve me kohë në autoritetin mbikëqyrës, në këtë rast MAPL-në, ashtu siç parashihet me nenin 43.5 të LVL-së.

Ndërsa, sa i përket funksionimit të Komiteteve Obligative, në Komunën e Vitisë këto komitete kanë qenë pjesërisht funksionale. Në këtë periudhë, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 2 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete nuk ka mbajtur asnjë mbledhje.

Në Komunën e Vitisë, Komitetet Konsultative janë funksionale.

Kryetari i Komunës është pjesëmarrës i rregullt në mbledhjet e Kuvendit.

Kurse, sa i përket sistemit të teleprezencës, Komuna e Vitisë e ka funksionalizuar këtë sistem dhe se procesi i monitorimit të mbledhjeve të Kuvendit funksionon normalisht dhe pa ndonjë vështirësi.

Duhet theksuar se raporti i punës së këtij Kuvendi është miratuar.

Komuna e Vitisë e ka Rregulloren për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane.

Sa i përket vlerësimit të ligjshmërisë së akteve komunale, Komuna e Vitisë ka respektuar rekomandimin e MAPL-së lidhur me plotësimin e Statutit të Komunës së Vitisë, ku Komuna ka bërë ri shikimin e statutit, si dhe ka inkorporuar të gjitha rekomandimet e dhëna nga MAPL-ja.

Sa i përket funksionimit të KKSBS-së, në Komunën e Vitisë, ashtu sikurse në Komunitet tjera, ka vështirësi si në aspektin organizativ po ashtu edhe në atë financiar të kompensimit të anëtarëve të KKSBS-së. Gjatë periudhës së tre mujorit të parë të vitit 2012, KKSBS në Komunën e Vitisë ka mbajtur 2 mbledhje.

Aktet më të rëndësishme

Në periudhën janar – mars të vitit 2012, Kuvendi i Komunës së Vitisë ka miratuar 8 vendime, ndërsa nuk ka miratuar asnjë rregullore.

Obiliq

Kuvendi i Komunës së Obiliqit gjatë periudhës janar – mars të vitit 2012 ka mbajtur 3 mbledhje të rregullta, ndërsa nuk ka mbajtur asnjë mbledhje të jashtëzakonshme.

Kuvendi i Komunës së Obiliqit ka funksionuar normalisht duke pasur debate të shumta kuantitative, jo relevante për pikat të cilat ishin në rendin e ditës. Në Kuvendin e Komunës së Obiliqit është bërë shprehi që në çdo mbledhje fillimisht të ketë zënka fjalësh në mes të ekzekutivit dhe anëtarëve të kuvendit të opozitës, e herë pas here edhe nga pozita. Këto debate zgjasin shumë kohë deri edhe në 3 orë, duke mos thënë asgjë për pikat e rendit të ditës vetëm duke folur në terma të përgjithshëm, si dhe duke mos e respektuar Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Mbledhjet kanë qenë transparente, ndërkohë që ftesat e mbledhjeve janë dërguar në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Ndërsa, sa i përket funksionimit të Komiteteve Obligative, në Komunën e Obiliqit këto komitete kanë qenë pjesërisht funksionale. Në këtë periudhë, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 3 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete nuk ka mbajtur asnjë mbledhje.

Në Komunën e Obiliqit, Komitetet Konsultative janë të themeluara, mirëpo nuk janë funksionale.

Kryetari i Komunës është pjesëmarrës i rregullt në mbledhjet e Kuvendit.

Kurse, sa i përket sistemit të teleprezencës, Komuna e Obiliqit e ka funksionalizuar këtë sistem dhe se procesi i monitorimit të mbledhjeve të Kuvendit funksionon normalisht dhe pa ndonjë vështirësi.

Duhet theksuar se raporti i punës së këtij Kuvendi është miratuar.

Komuna e Obiliqit gjatë kësaj periudhe ka shpallur gjendje të jashtëzakonshme për shkak të kushteve të vështira atmosferikë që kanë mbretëruar në muajt e kaluar.

Sa i përket funksionimit të KKSB-së, në Komunën e Obiliqit, ashtu sikurse në Komunitet tjera, ka vështirësi si në aspektin organizativ po ashtu edhe në atë financiar të kompensimit të anëtarëve të KKSB-së. Gjatë periudhës së tre muajve të parë të vitit 2012, KKSB në Komunën e Obiliqit ka mbajtur 2 mbledhje.

Aktet më të rëndësishme

Kuvendi i Komunës së Obiliqit ka miratuar 5 akte komunale, prej tyre 3 vendime dhe 2 rregullore.

Hani i Elezit

Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit, gjatë periudhës janar – mars të vitit 2012 ka mbajtur 3 mbledhje të rregullta, ndërsa nuk ka mbajtur asnjë mbledhje të jashtëzakonshme.

Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit ka funksionuar normalisht, ku është respektuar në përpikmëri Rregullorja e Punës së Kuvendit nga Kryesuesi i Kuvendit, si dhe duke pasur një pajtueshmëri të plot me anëtarët e kuvendit.

Mbledhjet kanë qenë transparente, ndërkohë që ftesat e mbledhjeve janë dërguar në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Sa i përket funksionimit të Komiteteve Obligative për periudhën janar – mars 2012, në Komunën e Hanit të Elezit, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 3 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur vetëm 1 mbledhje.

Në Komunën e Hanit të Elezit, Komitetet Konsultative janë funksionale.

Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit herë pas here merr pjesë në mbledhjet e Kuvendit kurse mungesën e tij e plotëson nënkryetari i Komunës.

Kurse, sa i përket sistemit të teleprezencës, Komuna e Hanit të Elezit e ka funksionalizuar këtë sistem dhe se procesi i monitorimit të mbledhjeve të Kuvendit funksionon normalisht dhe pa ndonjë vështirësi.

Duhet theksuar se raporti i punës së këtij Kuvendi është miratuar.

Sa i përket funksionimit të KKS-së, në Komunën e Hanit të Elezit, ashtu sikurse në Komunitet tjera, ka vështirësi si në aspektin organizativ po ashtu edhe në atë financiar të kompensimit të anëtarëve të KKS-së. Gjatë periudhës së tre muajve të parë të vitit 2012, KKS në Komunën e Hanit të Elezit ka mbajtur 2 mbledhje.

Aktet më të rëndësishme

Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit ka miratuar 20 akte komunale, prej tyre ka miratuar 19 vendime dhe 1 rregullore.

Kllokot

Kuvendi i Komunës së Kllokotit, gjatë periudhës janar – mars të vitit 2012 ka mbajtur 3 mbledhje të rregullta, ndërsa nuk ka mbajtur asnjë mbledhje të jashtëzakonshme.

Kuvendi i Komunës së Kllokotit ka funksionuar normalisht, ku është respektuar në përpikmëri Rregullorja e Punës së Kuvendit nga Kryesuesi i Kuvendit, si dhe duke pasur një pajtueshmëri të plot me anëtarët e kuvendit. Ka pasur debate të ndryshme, por të gjitha janë konsideruar konstruktive nga anëtarët e kuvendit.

Mbledhjet kanë qenë transparente, ndërkohë që ftesat e mbledhjeve janë dërguar në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Sa i përket funksionimit të Komiteteve Obligative për periudhën janar – mars 2012, në Komunën e Kllokotit, Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete kanë mbajtur nga 3 mbledhje.

Në Komunën e Kllokotit, Komitetet Konsultative ende nuk janë themeluar.

Kryetari i Komunës është pjesëmarrës i rregullt në mbledhjet e Kuvendit.

Sa i përket sistemit të teleprezencës, Komuna e Kllokotit e ka funksionalizuar këtë sistem dhe se procesi i monitorimit të mbledhjeve të Kuvendit funksionon normalisht dhe pa ndonjë vështirësi.

Duhet theksuar se raporti i punës së këtij Kuvendi është miratuar.

Sa i përket funksionimit të KKSBS-së, në Komunën e Kllokotit, ashtu sikurse në Komunitet tjera, ka vështirësi si në aspektin organizativ po ashtu edhe në atë financiar të kompensimit të anëtarëve të KKSBS-së. Gjatë periudhës së tre muajve të parë të vitit 2012, KKSBS në Komunën e Kllokotit ka mbajtur 3 mbledhje.

Aktet më të rëndësishme

Kuvendi i Komunës së Kllokotit ka miratuar 7 akte komunale, prej tyre 6 vendime dhe 1 rregullore.

Partesh

Kuvendi i Komunës së Parteshit, gjatë periudhës janar – mars të vitit 2012 ka mbajtur 2 mbledhje të rregullta dhe 2 mbledhje të jashtëzakonshme.

Kuvendi i Komunës së Parteshit ka funksionuar normalisht, mirëpo me disa vështirësi në funksionimin e punës së Kuvendit, për shkak të mos përkrahjes së proceseve nga ana e opozitës. Dukuri e këtij Kuvendi është mos miratimi i asnjë akti nga opozita. Ka pasur raste kur në mungesë të shumicës së pozitës, në momentin e kalimit të vendimeve për në procesin e votimit, këto vendime nuk miratoheshin. Si rezultat i gjendjes së krijuar, një mbledhje e Kuvendit ka dështuar për shkak se nuk është arritur të miratohet ndonjë akt komunal.

Mbledhjet kanë qenë transparente, ndërkohë që ftesat e mbledhjeve janë dërguar në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Sa i përket funksionimit të Komiteteve Obligative për periudhën janar – mars të vitit 2012, në Komunën e Parteshit, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 3 mbledhje kurse Komiteti për Komunitete ka mbajtur vetëm 1 mbledhje.

Në Komunën e Parteshit, Komitetet Konsultative ende nuk janë themeluar.

Kryetari i Komunës nuk merr pjesë në mbledhjet e Kuvendit, kurse mungesën e tij e plotëson nënkryetari i Komunës.

Sa i përket sistemit të teleprezencës, Komuna e Parteshit e ka funksionalizuar këtë sistem dhe se procesi i monitorimit të mbledhjeve të Kuvendit funksionon normalisht dhe pa ndonjë vështirësi.

Duhet theksuar se raporti i punës së këtij Kuvendi është miratuar.

Sa i përket funksionimit të KKS-së, në Komunën e Parteshit, ashtu sikurse në Komunitet tjera, ka vështirësi si në aspektin organizativ po ashtu edhe në atë financiar të kompensimit të anëtarëve të KKS-së. Gjatë periudhës së tre mujorit të parë të vitit 2012, KKS në Komunën e Parteshit ka mbajtur 2 mbledhje.

Aktet më të rëndësishme

Kuvendi i Komunës së Kllokotit ka miratuar 6 akte komunale, prej tyre 3 vendime dhe 3 rregullore.

Dragash

Kuvendi i Komunës së Dragashit, gjatë periudhës janar – mars të vitit 2012 ka mbajtur 3 mbledhje të rregullta dhe 1 mbledhje të jashtëzakonshme.

Kuvendi i Komunës së Dragashit ka funksionuar normalisht dhe se nuk ka pasur ndonjë pengesë në funksionimin e tij. Gjithashtu, duhet të theksohet se ka pasur koordinim në mes anëtarëve të kuvendit për pikat të cilat diskutoheshin. Po ashtu, debatet kanë qenë konstruktive.

Mbledhjet kanë qenë transparente, ndërkohë që ftesat e mbledhjeve janë dërguar në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Sa i përket funksionimit të Komiteteve Obligative për periudhën janar – mars të vitit 2012, në Komunën e Dragashit, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 3 mbledhje kurse Komiteti për Komunitete ka mbajtur vetëm 1 mbledhje.

Në Komunën e Dragashit, Komitetet Konsultative ende nuk janë themeluar për shkak se nuk a kanë parë të arsyeshme themelimin, si dhe funksionimin e tyre.

Kryetari i Komunës nuk merr pjesë në mbledhjet e Kuvendit, kurse mungesën e tij e plotëson nënkryetari i Komunës.

Sa i përket sistemit të teleprezencës, Komuna e Dragashit e ka funksionalizuar këtë sistem dhe se procesi i monitorimit të mbledhjeve të Kuvendit funksionon normalisht dhe pa ndonjë vështirësi.

Duhet theksuar se raporti i punës së këtij Kuvendi është miratuar.

Komuna e Dragashit gjatë kësaj periudhe ka shpallur gjendjen e jashtëzakonshme për shkak të kushteve të vështira atmosferikë që kanë mbretëruar në muajt e kaluar.

Sa i përket funksionimit të KKSB-së, në Komunën e Dragashit, ashtu sikurse në Komunitet tjera, ka vështirësi si në aspektin organizativ po ashtu edhe në atë financiar të kompensimit të anëtarëve të KKSB-së. Gjatë periudhës së tre mujorit të parë të vitit 2012, KKSB në Komunën e Dragashit ka mbajtur 2 mbledhje.

Aktet më të rëndësishme

Kuvendi i Komunës së Dragashit ka miratuar 6 akte komunale, prej tyre 3 vendime dhe 3 rregullore.

Të gjeturat

- Është konstatuar një shkelje ligjore me rastin e marrjes së Vendimit për bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të paluajtshmërisë në pronësi shoqërore, pronë e Kuvendit të Komunës së Vitisë. Ky vendim është i kundërligjshëm për shkak se nuk është në pajtim me nenin 5 pika 2 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 03/L-226.
- Kuvendi i Komunës së Vitisë dhe Klllokotit nuk i dërgojnë me kohë materialin e mbledhjeve në autoritetin mbikëqyrës, në këtë rast MAPL-në, ashtu siç e parasheh neni 43.5 i LVL-së.
- Në Komunën e Klllokotit, Parteshit dhe Dragashit, komitetet konsultative ende nuk janë themeluar.
- Në Komunën e Obiliqit, komitetet konsultative nuk janë funksionale.

KOMUNAT: MITROVICË, SKENDERAJ, VUSHTRRI DHE GLLOGOC

Mbledhjet e mbajtura

Gjatë 3 mujorit të parë të vitit 2012, Kuvendet e Komunave: **Mitrovicë, Skenderaj, Vushtri dhe Glllogoc** kanë zhvilluar ritëm të kënaqshëm në mbajtjen e mbledhjeve. Në këtë periudhë raportuese, kuvendet e këtyre komunave kanë mbajtur gjithsej 11 mbledhje.




Fig. 24. Numri i mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave: Mitrovicë, Skenderaj, Vushtri dhe Glllogoc

Nga figura e sipërme shihet se Kuvendet e Komunave: Mitrovicë, Skenderaj, Vushtri dhe Glllogoc, gjatë periudhës janar-mars 2011 kanë mbajtur nga 3 mbledhje, përderisa Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë ka mbajtur 2 mbledhje.

Komitetet Obligative dhe Komitetet e tjera kanë qenë funksionale në periudhën janar – mars 2012. Në Komunën e Mitrovicës dhe Skenderajt, KPF dhe KK kanë mbajtur nga 3 mbledhje, në Komunën e Vushtrrisë KPF ka mbajtur 3 mbledhje, kurse KK 2 mbledhje, ndërsa në Komunën e Glllogocit, KPF ka mbajtur 2 mbledhje, kurse KK 3 mbledhje.




Fig.25. Numri i mbledhjeve të Komiteteve të obligueshme: Mitrovicë, Skenderaj, Vushtrri dhe Gllogoc

Rrjedha e punës së Kuvendeve të Komunave, është shoqëruar me diskutime konstruktive, si nga opozita por edhe nga pozita, për pikat e rendit të ditës të cilat kanë qenë më me prioritet për qytetarin. Rregullorja e Punës së Kuvendit është respektuar nga Kuvendet e këtyre Komunave.

Mbledhjet e mbajtura kanë qenë transparente për publikun. Zakonisht në takime është vërejtur prezenca e OSBE-së të cilët monitorojnë punën e Kuvendeve të Komunave, OJQ-ve të ndryshme, mjeteve të informimit, si dhe e qytetarëve të interesuar.

Informimi i qytetarëve për mbledhje apo ndonjë aktivitet të Komunës bëhet përmes shpalljeve publike dhe ueb faqes së Komunës.

Sa i përket dërgimit të ftesave dhe materialeve të mbledhjes së Kuvendit, gjatë 3 mujorit të parë të vitit 2012, Komuna e Mitrovicës, Skenderajt, Vushtrrisë dhe Gllogoc, i kanë dërguar me kohë ftesat dhe materialet e mbledhjes së Kuvendit.

Krahas numrit të mbledhjeve, është miratuar një numër i konsideruar i akteve në Kuvendet e këtyre Komunave. Sipas të dhënave, rezulton se Kuvendet e këtyre Komunave kanë miratuar gjithsej 44 vendime dhe 6 rregullore.




Fig.26. Numri i akteve të miratuara në Kuvendet e Komunave: Mitrovicë, Skenderaj, Vushtrri dhe Glogoc

Kuvendi i Komunës së Mitrovicës ka miratuar 20 vendime dhe 3 rregullore, Kuvendi i Komunës së Skenderajt ka miratuar 8 vendime dhe 3 rregullore, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë ka miratuar 9 vendime dhe asnjë rregullore, kurse Kuvendi i Komunës së Glogocit ka miratuar 7 vendime dhe asnjë rregullore.

Sistemi i teleprezencës ka funksionuar normalisht në këto komuna.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi mbanë takime të rregullta në Komunën e Mitrovicës, Skenderajt dhe Vushtrrisë. Gjatë periudhës tre mujore, ky Këshill në Komunën e Mitrovicës ka mbajtur 7 mbledhje, në Skenderaj 3 mbledhje, në Vushtrri 2 mbledhje, ndërsa në Glogoc asnjë mbledhje.




Fig.27. Numri i takimeve të KKSBB-ve në komunat: Mitrovicë, Skenderaj, Vushtrri dhe Glogoc

Mitrovicë

Kuvendi i Komunës së Mitrovicës, gjatë kësaj periudhe tre mujore i ka mbajtur 3 mbledhje të rregullta, ndërsa nuk ka mbajtur mbledhje të jashtëzakonshme.

Kuvendi i Komunës së Mitrovicës ka funksionuar normalisht. Çdo pikë e rendit të ditës ka zgjuar interesim për diskutim nga anëtarët e kuvendit të cilët po thuajse në të gjitha mbledhjet e Kuvendit kanë reflektuar pozitivitetet dhe pjesëmarrje të madhe në trajtimin e çështjeve të ndryshme.

Mbledhjet kanë qenë transparente, ndërkohë që ftesat e mbledhjeve dhe materialet përcjellëse të rendit të ditës janë dërguar me kohë.

Sa i përket funksionimit të Komiteteve Obligative, këto Komitete kanë qenë funksionale dhe kanë mbajtur këtë numër të mbledhjeve: Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete kanë mbajtur nga 3 mbledhje.

Në Komunën e Mitrovicës, Komitetet Konsultative janë funksionale.

Kryetari i Komunës është pjesëmarrës i rregullt në mbledhjet e Kuvendit.

Sa i përket sistemit të teleprezencës, Komuna e Mitrovicës e ka funksionalizuar këtë sistem dhe se procesi i monitorimit të mbledhjeve të Kuvendit funksionon normalisht dhe pa ndonjë vështirësi.

Duhet theksuar se raporti i punës së këtij Kuvendi është miratuar.

Skenderaj

Kuvendi i Komunës së Skenderajt gjatë periudhës së tre mujorit të parë të vitit 2012 ka mbajtur 3 mbledhje të rregullta, ndërsa nuk ka mbajtur mbledhje të jashtëzakonshme.

Kuvendi i Komunës së Skenderajt ka funksionuar normalisht. Çdo pikë e rendit të ditës ka zgjuar interesim për diskutim nga anëtarët e kuvendit të cilët po thuajse në të gjitha mbledhjet e Kuvendit kanë reflektuar pozitivitetet dhe pjesëmarrje të madhe në trajtimin e çështjeve të ndryshme.

Mbledhjet kanë qenë transparente, ndërkohë që ftesat e mbledhjeve dhe materialet përcjellëse të rendit të ditës janë dërguar me kohë.

Sa i përket funksionimit të Komiteteve Obligative, këto Komitete kanë qenë funksionale dhe kanë mbajtur këtë numër të mbledhjeve: Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete kanë mbajtur nga 3 mbledhje.

Në Komunën e Skenderajt, Komitetet Konsultative janë funksionale.

Sa i përket miratimit të akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Skenderajt ka miratuar 8 vendime dhe 3 rregullore.

Sa i përket sistemit të teleprezencës, Komuna e Skenderajt e ka funksionalizuar këtë sistem dhe se procesi i monitorimit të mbledhjeve të Kuvendit funksionon normalisht dhe pa ndonjë vështirësi.

Duhet theksuar se raporti i punës së këtij Kuvendi është miratuar.

Vushtri

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, gjatë periudhës së tre mujorit të parë të vitit 2012 ka mbajtur 2 mbledhje të rregullta, ndërsa nuk ka mbajtur mbledhje të jashtëzakonshme.

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë ka funksionuar normalisht. Çdo pikë e rendit të ditës ka zgjuar interesim për diskutim nga anëtarët e kuvendit të cilët po thuajse në të gjitha mbledhjet e Kuvendit kanë reflektuar pozitivitetet dhe pjesëmarrje të madhe në trajtimin e çështjeve të ndryshme.

Mbledhjet kanë qenë transparente, ndërkohë që ftesat e mbledhjeve dhe materialet përcjellëse të rendit të ditës janë dërguar me kohë.

Sa i përket funksionimit të Komiteteve Obligative, këto Komitete kanë qenë funksionale dhe kanë mbajtur këtë numër të mbledhjeve: Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 3 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur nga 2 mbledhje.

Në Komunën e Vushtrrisë, Komitetet Konsultative janë funksionale.

Sa i përket miratimit të akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë ka miratuar 9 vendime dhe 1 rregullore.

Kryetari i Komunës merr pjesë në mbledhjet e kuvendit.

Sa i përket sistemit të teleprezencës, Komuna e Vushtrrisë e ka funksionalizuar këtë sistem dhe se procesi i monitorimit të mbledhjeve të Kuvendit funksionon normalisht dhe pa ndonjë vështirësi.

Duhet theksuar se raporti i punës së këtij Kuvendi është miratuar.

Glllogoc

Kuvendi i Komunës së Glllogocit, gjatë periudhës së tre mujorit të parë të vitit 2012 ka mbajtur 2 mbledhje të rregullta, ndërsa nuk ka mbajtur mbledhje të jashtëzakonshme.

Kuvendi i Komunës së Glllogocit ka funksionuar normalisht. Çdo pikë e rendit të ditës ka zgjuar interesim për diskutim nga anëtarët e kuvendit të cilët po thuajse në të gjitha mbledhjet e Kuvendit kanë reflektuar pozitivitetet dhe pjesëmarrje të madhe në trajtimin e çështjeve të ndryshme.

Mbledhjet kanë qenë transparente, ndërkohë që ftesat e mbledhjeve dhe materialet përcjellëse të rendit të ditës janë dërguar me kohë.

Sa i përket funksionimit të Komiteteve Obligative, këto Komitete kanë qenë funksionale dhe kanë mbajtur këtë numër të mbledhjeve: Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 2 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur nga 3 mbledhje.

Në Komunën e Glllogocit, Komitetet Konsultative janë funksionale.

Sa i përket miratimit të akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Glllogocit ka miratuar 7 vendime, ndërsa nuk ka miratuar asnjë rregullore.

Kryetari i Komunës, rregullisht merr pjesë në mbledhjet e kuvendit.

Kurse, sa i përket sistemit të teleprezencës, Komuna e Glllogocit e ka funksionalizuar këtë sistem dhe procesi i monitorimit funksionon normalisht.

Të gjeturat

- Në Komunën e Glllogocit, KKSB të funksionalizohet.

Konkluzione

- Përgjithësisht komunat kanë respektuar Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe ligje të tjera sektoriale;
- Afatet dhe njoftimet për mbledhje të kuvendeve, si dhe dërgimi me kohë i materialit të mbledhjeve të Kuvendit, kryesisht janë respektuar;
- Në shumicën e komunave është miratuar Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2012;
- Mbetet ende punë për tu bërë nga komunat lidhur me azhurnimin e informatave në ueb-faqet zyrtare;
- Komunat kanë shpallur gjendje të jashtëzakonshme, veprim që bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës;
- Komuna e Malishevës edhe për këtë periudhë nuk ka miratuar Rregulloren për Përdorim të Gjuhëve;
- Në Komunën e Lipjanit ende vazhdon të jenë 2 nënkryetarë nga komunitetet shumicë, edhe për kundër shkresës së dërguar nga MAPL;
- Komuna e Mamushës, Shtërpcës, Graçanicës, Ranillugut, Kamenicës dhe Glllogocit nuk kanë mbajtur asnjë mbledhje të KKSB-së;
- Në Komunën e Malishevës ende nuk është bërë zëvendësimi i anëtarit të Kuvendit z. Bekim Samadraxha, i cili që një kohë të gjatë nuk merr pjesë në punimet e Kuvendit.
- Në Komunën e Kaçanikut, Komiteti për Komunitete nuk ka mbajtur asnjë mbledhje.
- Në Komunën e Podujevës, Kryetari i Komunës ka raportuar vetëm një herë para anëtarëve të kuvendit, duke mos respektuar dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, ku kryetari raporton para Kuvendit të Komunës së paku dy herë në vit.
- Në shumicën e Komunave, Komitetet Konsultative ende nuk janë themeluar.

Rekomandimet e përgjithshme

Në bazë të të gjeturave në raport, Divizioni i monitorimit ka vënë në theks disa rekomandime për komunat, të paraqitura si në vijim:

- Komunat të vazhdojnë respektimin e afateve të njoftimit për mbledhje dhe të dërgimit me kohë të materialit të mbledhjes së Kuvendit, sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale;
- Komunat të dërgojnë me rregull aktet e miratuara për shqyrtim të ligjshmërisë në organin mbikëqyrës;
- Komunat t'i rishqyrtojnë të gjitha vendimet që MAPL i vlerëson se nuk janë në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Rekomandohen komunat në shfrytëzimin e mundësisë për konsultim paraprak para nxjerrjes së vendimeve;
- Të funksionalizohen dhe azhurnohen me informata ueb faqet zyrtare të komunave;
- Komuna e Malishevës të miratoj Rregulloren për Përdorimin e Gjuhëve;
- Komuna e Lipjanit të harmonizojë numrin e drejtorive konform Statutit;
- Komuna e Mamushës, Shtërpcës, Graçanicës, Ranillugut, Kamenicës dhe Glllogocit të funksionalizojnë KKSB-të;
- Komunat të themelojnë dhe të funksionalizojnë Komitetet Konsultative, konform nenit 73 të LVL-së;
- Komuna e Malishevës të bëjë zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit me anëtar të ri;
- Komuna e Kaçanikut të bëjë përpjekje në aktivizimin e Komitetit për Komunitete;
- Komuna e Podujevës të përmbush kriterin ligjor lidhur me raportimin e Kryetarit të Komunës para Kuvendit.
- Komuna e Lipjanit, të respektoj dispozitat ligjore në çështjen e emërimit të dy nënkryetarëve të komunës nga komuniteti shumicë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Raporti i kompletuar është hartuar nën mbikëqyrjen e z. Xhevat Tafa - Drejtor i Departamentit për Vetëqeverisje Lokale dhe z. Diellor Gashi – Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave;

Raporti është hartuar nga zyrtarët përgjegjës të Komunave:

Diellor Gashi - Gjakovë, Deçan, Rahovec dhe Junik

Gëzim Sahiti - Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Shtërpçë, Graçanicë dhe Mamushë

Hamit Fazliu - Mitrovicë, Drenas, Skënderaj dhe Vushtrri

Kujtim Aliu - Viti, Obiliq, Hani i Elezit, Kllokot, Partesh dhe Dragash

Manushaqe Muçaj - Pejë, Klinë, Istog, Malishevë dhe Suharekë

Zajrete Sylejmani - Prishtinë, Fushë-Kosovë, Lipjan dhe Podujevë

Yll Valla - Gjilan, Prizren, Kamenicë, Novobërdë dhe Ranillug

Për saktësinë e të dhënave të paraqitura në pjesë të raportit janë përgjegjës zyrtarët e Divizionit të Monitorimit.

E drejta autoriale e këtij raporti i takon Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.